



**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**  
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

## **RAPORTI VJETOR 2009**

**Janar 2010**

**SHKURTIME**

CEB	Banka e Këshillitë Evropës
IDA	Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim
BB	Banka Botërore
IDB	Banka Islamike e Investimeve
GoA	Qeveria Shqiptare
KGK	Komiteti i Granteve Konkurruese
KfW	Banka Gjermane për Investim
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
MIS	Sistemi Menaxhimittë Informacionit
NjQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
OFID	Fondi i OPEC për Zhvillim Nderkombetar
PNMZM	Plani i Ndjekjessë Masave Zbutëse mbi Mjedisin
PZHL	Plani i Zhvillimit Lokal
CES	Counsalting Engineers Salzgitetter
RI	Roughton International
SIF	Fondi i Investimit Social
FIDIC	Federata Nderkombetare e Konculences Inxhinierike (International Federation of Consulting Engineers)

## Pasqyra e lëndës

1. PERMBLEDHJE .....	4
2. RAPORTI I AKTIVITETIT .....	7
2.1 Programi “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore & Lokale në Shqipëri” .....	7
2.2 Programi “Punët në komunitet III” financuar nga CEB.....	12
2.3 Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” financuar nga KfW .....	15
2.4 Programi “Punëtnë Komunitet II” financuar nga Banka Botërore.....	17
2.5 Programi i investimeve Qeveritare 2006-2009 .....	18
2.6 Granti Konkurrues 2009.....	19
3. AKTIVITETI INSTITUCIONAL .....	20
3.1 Menaxhimi Financiar.....	20
3.2 Komunikimi dhe Informimi.....	26
3.3 Monitorimi dhe Vlerësimi.....	27
3.4 Auditimi i brendshëm .....	28
4. AKTIVITETE TE TJERA .....	31
4.1 Miratimi i ligjit për Fondin Shqiptar të Zhvillimit.....	31
4.2 Misioni i Vlerësimit të Bankës Botërore për programin “Rrugët Dytësore dhe Lokale” .....	31
4.3 Misioni i Vlerësimit për “Punët në Komunitet I dhe II” .....	32
4.4 Misioni i vlerësimit të KfW-së për programin “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale...32	
5. ANEKSE .....	33
5.1 Informacion mbi nen-projektet e programit “Punëtnë komunitet III” .....	34
5.2 Informacion mbi nen-projektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga Banka Botërore (IDA).....	36
5.3 Informacion mbi nen-projektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga OFID.....	36
5.4 Informacion mbi nen-projektet e programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, financuar nga Banka e Keshillit të Europës .....	37
5.5 Tabela e Skemave të Ujësjetësve fizibel, programi “Ujësjetësit Rurale” .....	38
5.6 Realizimi i zërave të buxhetit për vitin 2009 (sipas donatoreve) .....	39
5.7 Shpenzimet sipas Donatoreve dhe Kategorive për vitin 2009 (në 000, Leke).....	41
5.8 Projekte në implementim gjatë vitit 2009.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## 1. PERMBLEDHJE

Në këtë raport paraqitet aktiviteti vjetor i kryer nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për vitin 2009. Raporti ofron një panoramë të ecurisë së programeve kryesore, aktivitetin institucional të FSHZH-së si edhe aktivitetet e planifikuara në vazhdim.

Viti 2009 është karakterizuar nga një intensitet i lartë aktivitetesh, volume punimesh, fondesh të alokuara, angazhimesh, dhe rezultatesh. Gjatë këtij viti ka hyrë në fazën e plotë të zbatimit programi i rëndësishëm i “Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, është avancuar në fazën e dytë të programit “Punët në komunitet III”, është përfunduar vlerësimi teknik i nën-projekteve të programit “Furnizimi me ujë i zonave rurale”. Krahas punës së kryer për realizimin me efikasitet të këtyre programeve, FSHZH, në funksion të detyrës së tij, ka zbatuar me sukses investime në infrastrukture me financim të drejtpërdrejtë të buxhetit të shtetit, si edhe ka vazhduar puna me asistimin teknik të Komitetit Ndërmintor për Grantet Konkurruese, duke mundur vlerësimin e rreth 420 projekteve. Një ngjarje e rëndësishme së veçantë për Fondin Shqiptar të Zhvillimit ka qenë saktësimi i statusit ligjor nëpërmjet një ligji të veçantë të aprovuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Një ecuri shumë të mirë ka pasur gjatë këtij viti programi “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale” duke marrë një vlerësim zyrtar prej Bankes Botërore si një projekt shumë i sukseshëm. FSHZH si agjensi implementuese e këtij programi ka vazhduar të kryejë me sukses rolin e saj në monitorimin, koordinimin dhe implementimin e shpejtë të tij, duke garantuar realizimin me cilësi dhe përgjegjshmëri të të gjitha objektivave të zhvillimit të programit. Gjatë këtij viti janë kryer punime në 222 km rrugë rajonale dhe lokale, janë përfunduar projektet teknike për 400 kilometra, janë vlerësuar dhe priorizuar 525 segmente rrugore, si dhe është kryer inventarizimi i plote i 3500 km rrugë rajonale dhe lokale. Brenda këtij viti në bashkëpunim me Ministrinë e Financave është kryer një punë voluminoze për plotësimin e materialeve dhe dokumentacionit të nevojshëm për negociimin e rreth 40 milion USD me IDB, 100 milion Euro me BERZH dhe BEI, IPA 33 Milionë Euro, Western Balkan Investment Framework grant 4 milion Euro, dhe rreth 70 milion USD me Qeverinë Japoneze. Përmbyllja e këtyre negociatave siguron pjesën më të madhe të fondit të parashikuar që duhet për realizimin e të gjithë programit. Eksperienca e grumbulluar gjatë kësaj faze të programit i ka lehtësuar FSHZH-së detyrën e negociimit për sigurimin e financimeve të mbetura, duke lehtësuar angazhimin e më shumë donatoreve në këtë program.

Si rrjedhojë e një angazhimi maksimal dhe një pune intensive, një negociimi të suksesshëm me donatorët, përgatitjes së projekteve dhe të gjitha dokumentacioneve të nevojshme për prokurimin dhe nënshkrimin e kontratave të punimeve, u bë e mundur që gjatë këtij viti, plani i investimeve të tejkalohet në një masë rreth 200% duke filluar punimet jo më në 110 km që ishin planifikuar por në 222 km. Pjesa më e madhe e kesaj arritjeje vjen si rrjedhojë e firmosjes në një kohë shumë të shpejtë të marrëveshjes së

financimit dhe të vendosjes në efikasitet në kohë rekord të fondit prej 40 milion Euro financuar nga CEB.

Në një letër dërguar FSHZH-së, Zv. Presidenti i Bankës Botërore për Evropën dhe Azinë Qendrore Z. Philippe Le Houérou, i cili vizitoi një nga objektet që po ndertohej, u shpreh i impresionuar me punën e bërë deri me tani në kuadër të projektit “Rrugët Dytësore dhe Lokale”, si edhe implementimin e kryer nga FSHZH.

Programi “Punët në Komunitet III”, i cili financohet nga CEB, paraqet një ecuri të kënaqshme në të dy komponentët e tij, si në asistencën teknike për ngritjen e kapaciteteve të NjQV-ve ashtu edhe në zbatimin e projekteve të infrastrukturës. Si rezultat i këtij projekti pesë NjQV janë të pajisura me plane të zhvillimit social e ekonomik lokal, hartuar me pjesëmarrje të gjere të komunitetit dhe katër NjQV të tjera - tashme kane një Plan Zhvillimi për Turizmin në territorin e tyre. Aktualisht janë përfunduar punimet në 19 nënprojekte, dhe janë në zbatim 11 nënprojekte. Vlen per tu përmendur se ky projekt përbën një risi në fushën e veprimtarisë së FSHZH-së sepse këto strategji shërbejnë për orientimin e investimeve të FSHZH-se dhe vetë komunave drejt qëllimeve strategjike e ndërhyrjeve të studiuara për nxitjen e zhvillimit ekonomik.

Programi “Furnizimi me ujë i zonave rurale” financuar nga KfW përmbylli këtë periudhë fazën parapërgatitore, fazën e seleksionimit në terren të objekteve për financim dhe ka hyre në fazën e përzgjedhjes së kompanive të projektimit. Njësia e Ujësjesve Rurale në bashkëpunim të ngushtë me konsulencën ndërkombëtare, ka kryer një sërë aktivitete të lidhura me përfundimin e manualit të programit, përfundimit të metodologjisë së vlerësimit të nën-projekteve, dhe ripunimin e fizibilitetit teknik sipas kërkesave specifike të Donatorit. Përgatitja e ketyre materialeve kaloi nepermjet një procesi konsultimi me departamentet teknike të FSHZH, me aktoret kryesore të projektit, si edhe me donatorin, që u përmbyll me një workshop.

Faza e përzgjedhjes ka vazhduar sipas planit me vlerësimet që u kryen në terren për 61 fshatra. Pas kryerjes së fizibilitetit teknik, rezultojnë 28 skema ujësjesish, me 50 fshatra përfitues, që plotësojnë kriteret e vendosura nga projekti për financim. Aktualisht është kryer edhe paravlerësimi i firmave të projektimit dhe supervizionit të punimeve. Kontraktimi i firmave të projektimit do të bëhet brenda tre-mujorit te parë 2010 sipas planit të aktiviteteve, dhe po rishikohet plani i aktiviteteve me qëllimin afrimin e datës së fillimit të punimeve.

Menaxhimi financiar gjatë vitit 2009, ka garantuar ekuilibrat financiarë të institucionit si edhe organizimin e gjithë aktivitetit ekonomik – financiar të tij brenda limiteve të programuara të financimit. Gjithashtu vëmendje i është kushtuar administrimit dhe menaxhimit të fondeve me përgjegjshmëri dhe transparence, si dhe monitorimit dhe mbikëqyrjes së detajuar të fondeve sipas komponentëve përkatës: investime infrastrukture, administrim të brendshëm, asistence teknike, etj.

Gjate kësaj periudhe, FSHZH ka arritur një realizim financiar në vleren 34,45 milion USD ose në masën 89 % të buxhetit vjetor të rishikuar. Gjate vitit 2009 FSHZH ka manaxhuar 54 kontrata per punime në infrastrukture me vlere rreth 71 milione USD nga të cilat, 42 kontrata me vlere rreth 60 milione USD, janë prokuruar dhe lidhur gjatë vitit 2009.

Në vijim të procedurave për miratimin e projekt ligjit për rregullimin e statusit ligjor të FSHZH-së bazuar në vendimin nr. 66të Bordit Drejtues, më datë 11.05.2009, u miratua në Kuvendin e Shqipërisë ligji nr. 10130, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”. Me Dekretin nr.6181, datë 25.05.2009, Presidenti i Republikës ka dekretuar shpalljen e ketij ligji dhe më datë 12.06.2009, ligji nr. 10130, datë 11.05.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, është botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Përsa më siper ky ligj ka hyrë në fuqi më datë 27.06.2009.

Ky ligj rikonfirmon statusin juridik të FSHZH-së si një organizatë jo fitimprurëse me personalitet juridik që *përcaktohet me ligj të veçantë*, si e vetmja mundësi ligjore për të ruajtur statusin aktual të FSHZH-së. Përcaktimi me ligj të veçantë i statusit juridik të FSHZH-së rregullon në mënyrë përfundimtare dhe të qëndrueshme funksionimin e saj si dhe forcon e garanton rolin e FSHZH-së si një organizëm i specializuar i shtetit shqiptar në zbatimin e projekteve të zhvillimit. Ligji i miratuar percakton ne menyre te qarte statusin ligjor te FSHZH-se, ne perputhje me legjisllacionin ne fuqi.

## 2. RAPORTI I AKTIVITETIT

### 2.1 Programi “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore & Lokale në Shqipëri”

Projekti “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore & Lokale”, bashkëfinancuar nga Banka Botërore dhe donatore të tjerë në vlerën 400 milion USD, synon të rrisë përpjekjet konkrete për përmirësimin e infrastrukturës në vend si edhe për rritjen e aksesit ndaj shërbimeve bazë dhe tregjeve, veçanërisht në zonat rurale nëpërmjet rehabilitimit të rreth 1500 km rrugë.

Projekti deri në Dhjetor 2009, është financuar nga Banka Botërore (20 milionë \$), OPEC Fund (15 milionë \$), Qeveria Shqiptare (5 milionë \$), CEB (56 milionë \$ ose 40 milionë Euro) dhe programi IPA 2008 (11 milionë \$ ose 8 milionë Euro), dhe ka avancuar netë gjithë komponentët e programit.


Në fazën e parë janë bërë efektive, janë hartuar projektet teknike, prokuruar dhe janë filluar punimet në segmentet rrugore të financuara nga BB dhe OPEC Fund. Me këto fonde janë financuar 11 projekte për akset rajonale më të rëndësishme të vendit në një gjatësi prej 108.7 km.

Në një kohë të shpejtë është vënë në efijencë edhe fondi prej 40 milion Euro financuar nga CEB.

Në fazën e dytë me fonde të CEB, janë financuar 11 projekte me një gjatësi totale prej 113.5 km që përbëjnë planin e parë të punës me fondet e CEB. Kjo fazë ka filluar nga zbatimi në Qershor 2009, dhe punimet janë në vazhdimësi.

Pas përfundimit nga konsulenti të fazës së studimit të fizibilitetit, u përfundua identifikimi i segmenteve rrugore që bëjnë pjesë në planin e dytë të punës, me rreth 100 km, për pjesën e mbetur të fondeve të CEB. Kater objekte të planit të dytë të punës u tenderuan në muajin Nëntor 2009.

Katër segmente, me një gjatësi prej 24.7 km janë financuar nga Programi IPA'08, ku procedurat janë të centralizuara, pra prokurimi e supervizioni i punimeve do të organizohen nga vetë Delegacioni i Bashkimit Evropian. Ka përfunduar procesi i përzgjedhjes së kompanisë së supervizionit, dhe tenderi i përzgjedhjes së kontraktorëve për zbatimin e punimeve. Pritet që në fillim të vitit 2010 të lidhen kontratat e punimeve.



## **Ecuria e deritanishme e projektit**

Komponentët kryesorë të projektit dhe ecuria e secilit prej tyre janë dhënë më poshtë:

**Komponenti i pare:** Financimi i aktiviteteve mbështetëse të të gjithë programit:

Ky komponent përfshin përgatitjen e bazës së të dhënave për rrugët dytesore & lokale si dhe përgatitjen e dokumentacionit të prokurimeve për fazën e implementimit. Përgatitja e këtij dokumentacioni është realizuar në bashkëpunim me konsulencën angleze Roughton International (RI).


Përsa i përket krijimit të bazës së të dhënave e prioritizimit, është krijuar një inventar i plotë me të dhëna të detajuara për rreth 3500 km, të identifikuar si rrugë kryesore të rrjetit rrugor rural. Këto segmente rrugore janë përzgjedhur nga secili Qark në bazë të prioriteteve e të shpenzimeve aktuale të mirëmbajtjes. Janë mbledhur të dhëna të hollësishme për të gjithë seksionet rrugore, (rreth 525 segmente) si popullsia, trafiku, gjendja (ashpërsia e rrugës), aksesit që krijon, si edhe varfëria në zonë. Është bërë një analizë shumë kritereshe për secilin nga këto seksione e përbërë nga disa komponentë. Në përfundim të inventarizimit të 3500 km rrugë dytesore dhe lokale, dhe analizës shume kritereshe për gjendjen e tyre, ka përfunduar dhe procesi i prioritizimit. FSHZH tashmë përveç inventarit, disponon dhe listën prioritizuar të rrugëve. Kjo listë do të orientojë dhe investimet që do të bëhen në kuadër të këtij programi.

Përsa i përket projekteve teknike, është përfunduar dokumentacioni për 400 km seksione rrugore, që është totali i seksioneve rrugore për të cilat kompania RI ofron konsulencë. Përgatitja e këtyre projekteve bazohet në udhëzuesin e përgatitur nga konsulencia teknike e Bankës Botërore. Ky udhëzues reflekton kriteret e projektimit të aplikuar në draftin e manualit të projektimit të rrugëve në Shqipëri. Për segmentet për të cilat është përgatitur draft projekti, ka filluar procedura e rishikimit të projekteve teknike nga ana e inspektoreve teknikë dhe socialë të FSHZH-së. Kontrata e konsulencës për këtë komponent ka përfunduar në muajin Nëntor. Konsulenti ka kryer të gjitha detyrimet kontraktuale dhe ka dorëzuar pranë FSHZH të gjitha raportet dhe dokumentacionet perkatëse në lidhje me projektin, inventarizim, prioritizim, përgatitja e projekteve teknike si dhe përgatitja e databes në GIS.





**Komponenti i dyte** – Financimi i punimeve civile për përmirësimin e rrugëve prioritare rajonale apo lokale.

Me anë të këtij komponenti janë duke u financuar punimet në 222 km rrugë dytesore dhe lokale të ndare në dy faza. Në fazën e parë po financohen 108.7 km akse rrugore në 12 Qarqe të vendit. Këto rrugë u përzgjedhën nëpërmjet një procesi pjesëmarrës dhe bazuar në kriteret objektive social-ekonomike dhe teknike, duke përfaqësuar akset kryesore rrugore të Qarqeve.





Gjithashtu bazuar në këto kritere në fazën e dytë u financuan 113.5 km rrugë rajonale që kryesisht janë vazhdim i segmenteve rrugore të fazës së parë. Ecuria e përgjithshme e gjithë projekteve ka qenë pozitive dhe mund të themi se standartet e reja të aplikuara në këtë projekt po japin rezultate të mira në lidhje me cilësinë e punimeve.



## Prokurimi

Të gjitha procedurat e prokurimit për punimet civile në këtë program janë kryer në përputhje me Udhëzuesit e Bankës Botërore “Guidelines: Procurement Under IBRD Loans and IDA Credits Procurement”. Të gjithë tenderat janë kryer nëpërmjet metodës “Tender i hapur ndërkombëtar”.

Gjate periudhës tremujorit të parë 2009, janë mbyllur procedurat e tenderimit dhe janë lidhur kontratat e punimeve për 11 segmentet e fazës së parë, si dhe prokurimi i kompanisë së supervizionit të punimeve në kuadër të këtij projekti. Në të njëjtën kohë këto kontrata përbejnë edhe totalin e segmenteve që ishin parashikuar të financoheshin në kuadër të projektit prej 40 milionë USD të financuar nga IDA, OFID dhe GoA. Kështu, bazuar në klauzolën e financimit retroaktiv nga donatori, i gjithë fondi i programuar për investimet publike nën këtë projekt është projektuar, tenderuar dhe kontraktuar vetëm 7 muaj pas bërjes efektive të fondeve.

Po kështu, menjëherë pas përfundimit të fazës së parë, po në muajin Mars u zhvilluan negociatat për miratimin e një financimi prej 40 milionë Euro nga CEB, duke synuar mundësinë e një financimi retroaktiv. Me miratimin e kësaj klauzole në negociata dhe duke pasur parasysh se konsulenca ndërkombëtare kishte përfunduar projektet për rreth 100 km të tjerë, FSHZH shpalli që në muajin Prill tenderat edhe për 10 segmente të tjerë të cilat do të financoheshin nga CEB. Vlera e paravlerësuar e këtyre segmenteve është rreth 20 milionë Euro apo rreth 50% e financimit të siguruar nga CEB.

Javën e parë të Qershorit u tenderuan 10 segmente me procedurën “tender i hapur ndërkombëtar”. Po këtu muaj u përfundua vlerësimi dhe u lidhen kontratat për zbatimin e 10 segmenteve të mësipërme. Kështu brenda 1 muaji nga bërja efektive e marrëveshjes së financimit (e cila ka një afat 3-vjeçar), kontrakti përfundoi pothuajse ½ e shumës totale të investimit. Të gjitha këto segmente kanë filluar nga puna gjate vitit 2009.

Gjate muajit Shtator u prokurua një segment tjetër rrugor dhe u lidh kontrata e punimeve dhe vazhdon zbatimi i tij. Në muajin Nentor po në kuadër të këtij Donatori u tenderuan 4 segmente të tjera rrugore, ka përfunduar procesi i vlerësimit të ofertave dhe janë duke u lidhur kontratat e punimeve.

## Supervizioni i kontratave të punimeve civile

Duke u nisur nga standardet e larta teknike të kërkuara nga ky projekt, është kontraktuar një kompani supervizioni ndërkombëtare me eksperience të gjera në këto lloje punimesh. Kompania Louis Berger SAS është kompania e kontraktuar në projektin e BB për supervizionin e të gjitha punimeve civile. Aktualisht po kryhet supervizioni i implementimit të 22 kontratave të punimeve, të cilat janë bazuar në parametrat e FIDIC. FIDIC është Federata Ndërkombëtare e Konsulencës Inxhinierike dhe përfaqëson këtë industri në rang botëror, duke qenë e njohur për punën e kryer në drejtim të përcaktimit të Kushteve të Kontratave për industrinë e ndërtimit anembanë globit. Me qëllim

përvetësimin më të plotë të kushteve të këtyre kontratave aplikuar kjo në kontratat e punimeve që FSHZH po implementon në kuadër të Programit të “Rrugëve Dytësore dhe Lokale”, në muajin Korrik u realizua një trajnim nga FIDIC. Në këtë seminar u trajnuan 23 specialistë të Departamentit të Infrastrukturës të angazhuar drejtpërsëdrejti në ndjekjen e kontratave të ndërtimit në kuadër të Projektit “Përmirësimi i rrugëve dytësore dhe lokale”.

Eksperienca e fituar nga ky seminar do të ndikojë në rritjen e kapaciteteve menaxhuese dhe administrative të kontratave të punimeve nga ana e Departamentit të Infrastruktures së FSHZH-së, si për kontratat në zbatim, ashtu edhe për të ardhmen. Vendosija e standarteve ndërkombëtare në procedurat e punës së FSHZH-se ka qene dhe mbetet një prioritet i strategjisë afatmesme të institucionit dhe që synon ti paraprijë nevojave për zhvillim në vend.

### **Ngritja e kapaciteteve të pushtetit lokal per funksionimin dhe mirembajtjen**

Gjatë këtij viti filluan trajnimet në 12 Qarqet e Shqipërisë për mirëmbajtjen e rrjetit rrugor të rrugëve rurale. Në këtë komponent të rëndësishem të projektit përfshihet ngritja e kapaciteteve të komunave me anë të trajnimeve të bëra nga ana e ekspertëve të FSHZH-së.

Trajnimi i parë është kryer në Shkodër në Dhjetor 2009, dhe më pas kanë vijuar trajnimet e tjera në Qarqet Dibër, Korçë, Fier etj. Është parashikuar që deri në fund të projektit të realizohen rreth 21 cikle trajnimesh në të gjithë Shqipërinë. Aktualisht janë përfunduar me sukses ciklet e trajnimit në pesë Qarqe.

Objektivi kryesor i këtyre trajnimeve është familjarizimi i Njësive të Qeverisjes Vendore me aktivitetin që duhet kryer për mirëmbajtjen rutinë të rrugëve, ofrimi i një trajnimi profesional për personelin përgjegjës të tyre si edhe aftësimin e tyre për të menaxhuar kontraktorët e sektorit privat.

Në fund të çdo aktiviteti, pjesëmarrësit pajisen me Udhëzuesin për Mirëmbajtjen e Rrugëve Rurale, i cili është hartuar dhe botuar nga FSHZH, ku tregohen qartë hapat që duhen ndjekur për një mirëmbajtje sa më cilësore të rrugëve.

Risia e projektit të “Rrugëve Dytësore dhe Lokale” është sigurimi i qëndrueshmërisë dhe funksionalitetit afatgjatë të rrjetit rrugor nëpërmjet kontraktimit të shërbimit të mirëmbajtjes në sektorin privat.

### **Konkluzione:**

Projekti ka paraqitur një performancë shumë të kënaqshme në të gjithë komponentët e tij. I njëjti konstatim është bërë edhe nga misioni zyrtar i vlerësimit të Bankës Botërore i cili në Aide-Mémoire-in e Shtatorit 2009, konstaton se ecuria e përgjithshme e projektit është shumë e mirë. Ky vlerësim i Bankes Boterore u rikonfirmua edhe nga letra dërguar FSHZH-se, nga Zëvendës Presidenti i Bankës Botërore për Evropën dhe Azinë Qendrore Z. Philippe Le Houérou, i cili shprehet se është i impresionuar me punën e bërë deri me tani në kuadër të projektit “Rrugët Dytësore dhe Rurale”, si edhe implementimin e kryer nga FSHZH.

Aktualisht janë në proces implementimi 222 km rruge rajonale. Gjithashtu është përfunduar me sukses një nga objektivat e konsulences ndërkombëtare për hartimin e projekteve teknike dhe dokumentacioneve të prokurimit për një total prej 400 km. FSHZH si agjenci implementuese e këtij programi po vazhdon të kryejë me sukses rolin e saj në monitorimin, koordinimin dhe implementimin e shpejtë të këtij programi, duke garantuar realizimin me cilësi dhe përgjegjshmëri të të gjitha objektivave të zbatimit të programit.

Eksperiencia e grumbulluar gjatë kësaj faze të programit i ka lehtësuar FSHZH-së detyrën e negocimit për sigurimin e financimeve të mbetura, duke mundësuar angazhimin e më shumë donatorëve në këtë program. Të gjitha marrëveshjet që po negociohen kanë një facilitet të konsiderueshëm, pasi të gjitha kostot për zërat që nuk janë investim, janë mbuluar me anë të kredisë së Bankës Botërore.

## 2.2 Programi “Punët në komunitet III” financiar nga CEB


Projekti “Punët në komunitet III” financohet nga CEB në vlerën 14.38 milion Euro, dhe ka si qëllim të nxisë zhvillimin social ekonomik të zonave rurale të vendit, të cilat kanë potenciale të zhvillimit ekonomik, veçanërisht në turizëm.

Në projekt janë përfshirë 16 komuna, të cilat janë të shpërndara gjeografikisht, dhe kanë tipare të veçanta të turizmit (komunat aplikojnë forma të ndryshme të turizmit: bregdetar, malor, historik, eko-turizëm, agroturizëm, etj) por edhe nevoja të ndryshme në aspektin e ndërtimit të kapaciteteve. Projekti ofron asistencë teknike të diversifikuara që ndryshon nga komuna në komunë dhe përshtatet në përputhje me nevojën që përballen stafi dhe të zgjedhurit lokal në secilën prej tyre.

Projekti është i lokalizuar në NjQV-të si vijon: Drenovë, Tregan, Fushë-Kuqe, Orikum, Qendër Vlorë, Kryevidh, Petran, Kutalli, Ulëz, Ishëm, Margegaj, Postribë, Velipojë, Rrashbull, Petrelë.

Programi “Punët në Komunitet III”, paraqet një ecuri të kënaqshme në të dy komponentët e tij, si në asistencën teknike për ngritjen e kapaciteteve të NjQV-ve ashtu edhe në zbatimin e projekteve të infrastrukturës.

Në fazën e parë u identifikuan komunat të cilat kanë një plan zhvillimi lokal, të hartuar qoftë me FSHZH-



në, qoftë me ndonjë organizatë tjetër. Në bazë të këtyre planeve u identifikuan projekte infrastrukturore të cilat do të financohen nga projekti.

Nga diskutime me të zgjedhurit lokalë u identifikuan NjQV-të të cilat kanë nevojë për hartimin e një plani të zhvillimit lokal. Si rezultat, pesë NjQV u përfshinë në procesin e hartimit me pjesëmarrje të planit të zhvillimit lokal. Këto NjQV janë: Tregan, Fushë-Kuqe, Kutalli, Drenovë dhe Orikum.

Gjithashtu u identifikuan NjQV-të të cilat vlerësojnë si prioritar, hartimin e një plani hapësinor dhe këto janë: Ulëz, Petrelë, Velipojë.

Katër NjQV të tjera identifikuan si prioritar hartimin e një plani të zhvillimit të turizmit. Këto janë: Ishëm, Kryevadh, Qendër Vlorë, Petran.

### Faza e parë e investimeve



Nga 16 projektet që janë përfshirë në listën e parë të financimit në kuadër të këtij programi deri tani :

- Janë lidhur të gjithat kontratat e punimeve;
- Punimet civile kane përfunduar në 14 nënprojekte;
- Në 2 nënprojekte po punohet për përfundimin e tyre brenda afatit të përcaktuar;
- Realizimi i punimeve është kryer në masën 100%
- Disbursimet janë kryer në masën 89%

### Faza e dytë e investimeve

Gjatë vitit 2009 është punuar njëkohësisht në mënyrë intensive për përgatitjen e fazës së dyte të këtij programi. Për fazën e dyte të këtij programi statusi aktual i 14 nënprojekteve është si me poshtë:

- 9 projekte janë në fazën e zbatimit të punimeve;
- 5 projekte në fazën e garancisë;
- Realizimi i punimeve është kryer në masën 62%
- Disbursimet janë kryer në masën 54%



### **Faza e tretë e investimeve**

Gjatë tre-mujorit të fundit të vitit 2009 u bë llogaritja e fondeve të mbetura për secilën NjQV dhe në përputhje me projektet prioritare të dala nga procesi i planifikimit lokal u hartua edhe plani i tretë i punës për përdorimin e fondeve të mbetura që do të financohet gjatë vitit 2010. Në fazën e tretë të këtij programi përfshihen 10 nënprojekte infrastrukture. Në bazë të planit të punës së miratuar, pritet që keto projekte të përfundojnë brenda muajit Shtator 2010

### **Planet e Zhvillimit Lokal**

Si rezultat i këtij projekti pesë NjQV-të (Tregan, Orikum, Drenovë, Kutalli, F. Kuqe) janë pajisur me plane të zhvillimit social e ekonomik lokal hartuar me pjesëmarrje të gjerë të komunitetit.

Të gjitha planet e Zhvillimit Lokal janë miratuar në Këshillat e Njësive të Qeverisjes Vendore duke marrë formën finale.

NjQV-të u ndihmuan për hartimin e një plani konkret veprimi për një nga fushat prioritare të zhvillimit ekonomik, proces ky që sjell një risi në metodat e punës së deritanishme, duke ndihmuar që planet të bëhen sa më konkrete e të gatshme për zbatim. Në fillim të muajit Qershor filluan prezantimet e planeve sektoriale si më poshtë:

- Plani i Menaxhimit të Ujërave Termale (Ilixha) në Komunën Tregan, Qarku I Elbasanit.
- Plani i Prodhimit të Perimeve dhe Frutave të Freskëta në Komunën Kutalli, Qarku Berat.
- Plani Sektorial i Zhvillimit të Eko-turizmit në Komunën F.Kuqe, Qarku Lezhë.
- Plani Sektorial i Zhvillimit të Turizmit në Komunën Drenove, Korçë.
- Plani Sektorial i Zhvillimit të Turizmit në Orikum, Vlorë.

### **Planet e Zhvillimit të Turizmit**

Katër NjQV të tjera - Ishëm, Kryevidh, Qendër Vlorë, Petran – tashmë kanë një Plan Zhvillimi për Turizmin në territorin e tyre; plane që i orientojnë më mirë Komunitat drejt një zhvillimi të qëndrueshëm të fushave që kane zgjedhur.

Gjate muajit Prill-Qershor në zyrat e FSHZH u prezantuan katër Planet e Zhvillimit të Turizmit me prezencën e përfaqësuesve të NjQV-ve përkatëse. Këto prezantime shërbyen edhe si mundësi për të diskutuar rreth ceshtjeve kritike që planet ngritën si dhe për sugjerime të mundshme për t'u reflektuar në planin përfundimtar.

Planet përfshijnë një seksion të hapave të veprimit që do tu shërbejnë si një hartë komunave që duan të zhvillojnë turizmin në zonë në përfitim të komuniteteve lokale.

## Konkluzione:

Programi “Punët në Komunitet III”, paraqet një ecuri të kënaqshme në të dy komponentët e tij, si në asistencën teknike për ngritjen e kapaciteteve të NjQV-ve ashtu edhe në zbatimin e projekteve të infrastrukturës. Ky projekt përbën një risi në fushën e FSHZH-së sepse këto strategji shërbejnë për orientimin e investimeve të FSHZH dhe vetë Komunave drejt qëllimeve strategjike e ndërhyrjeve të studiuara për nxitjen e zhvillimit ekonomik.

Gjykojmë se një ndërhyrje e tillë e kombinuar (planifikim, trajnim e investime), ka si rezultat ndikim më të drejtpërdrejtë e më të madh në zhvillimin e zonave ku ndërhyhet.


### 2.3 Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale” financuar nga KfW

Programi “Furnizimi me ujë i zonave rurale” financuar nga KfW, konsiston në ndërtimin e rreth 28 skemave të ujësjellësve në 50 fshatra në Qarqet Diber, Shkodër dhe Kukës, duke kontribuar në përmirësimin e jetesës së 40.000 - 50.000 banoreve. Programi ka një kohëzgjatje 6 vjeçare dhe përfundon në fund të vitit 2014. Vlera e programit është 9 milion Euro (7.5 milion + 1.5 milion) për masat investuese dhe 1 milion Euro Grant për ngritje kapacitetesh (masat shoqëruese).

Në periudhën Janar-Shtator, është përmbyllur faza parapërgatitore si edhe është avancuar me fazën e seleksionimit në terren të objekteve për financim. FSHZH në bashkëpunim me konsulentin ndërkombëtar CES, ka kryer një sërë aktivitete të lidhura me përfundimin e manualit të programit, përfundimin e metodologjisë së vlerësimit të nën-projekteve, dhe ripunimin e fizibilitetit teknik sipas kërkesave specifike të donatorit.

Me përfundimin e fazës parapërgatitore u përgatit edhe “Inception Report” që përmban:

- Planin fillestar të aktiviteteve të detajuar për programin.
- Detyrat dhe planifikimet për çdo pjesëmarrës në program.
- Konceptet e Prokurimit për shërbimet e projektimit dhe për punimet e ndërtimit.



- d. Manual i shkurtër me rregullat dhe hapat më të rëndësishme për çdo aktivitet si edhe me procedurat administrative për tu respektuar nga pjesëmarrësit.
- e. Përgatitja e studimit standard të fizibilitetit bashkë me ToR për këtë qëllim.

Gjatë muajit Mars u zhvillua një proces konsultimi i materialeve të realizuara në fazën parapërgatitore me departamentet teknike të FSHZH, me aktorët kryesore të projektit, si edhe me Donatorin. Gjithashtu u përgatit fizibiliteti teknik pilot për fshatrat Frankth dhe Batër të Komunës Komsî – Mat, Qarku Dibër.

Të gjitha materialet e përgatitura u prezantuan në një workshop të përbashkët i cili u zhvillua në 26 Mars 2009 me pjesëmarrjen e FSHZH, KfW, Konsulentit CES, përfaqësues nga Ministria e Financave, Shoqata e Komunave, DPUK. Në këtë workshop u diskutua mbi elementët teknikë të metodologjisë dhe mjeteve të vlerësimit, duke evidentuar nevojën për adaptime të mëtejshme.

Ndryshimet e rena dakord në workshop u reflektuan në materialet e punës duke u prodhuar edhe fisha e fizibilitetit social dhe formularët e vlerësimit me pike si edhe përgatitja e dokumentit të angazhimit paraprak.

Me qëllim fillimin e fazës së përzgjedhjes, vendosjen e partneritetit dhe marrjes së angazhimit paraprak nga Qeverisja Lokale, në datë 21 Maj 2009 u organizua një takim me përfaqësues nga 31 Komuna të Qarqeve Shkodër, Kukës dhe Dibër. Gjate takimit u prezantua ecuria e deritanishme e programit, kriteret e vlerësimit të projekteve fituese si edhe u arrit një angazhim paraprak nga komunat që do jenë pjesë e këtij procesi.

Gjate muajve Maj-Qershor u kryen trajnimet e stafit të FSHZH-se me teknikat e reja të vlerësimit social dhe teknik, trajnime të cilat i hapen rrugën procesi të vlerësimit që u krye në terren gjatë muajit Qershor në 61 fshatra.

Në fund të këtij procesi u përpilua lista e shkurtër me fshatrat në të cilat u aplikua fizibiliteti teknik i cili përfundoi në fund të Shtatorit 2009. Në listen perfundimtare rezultojnë 28 skema ujësjellësish, me 50 fshatra përfitues, që plotësojnë kriteret e vendosura nga projekti për financim.

Gjate muajve Gusht – Shtator 2009 u bë edhe paravlerësimi i firmave të projektimit dhe supervizionit të punimeve. Firmat e përzgjedhura do të konkurrojnë me ofertat teknike dhe financiare në Janar 2010, nga ku do të përzgjidhen 4 firma fituese (për 4 lote), të cilat do të përgatisin projektet e zbatimit, dokumentat e tenderimit të punimeve dhe do të bëjnë supervizionimin e punimeve.

Kontraktimi i firmave të projektimit do të bëhet brenda tre-mujorit të parë 2010 dhe po rishikohet plani i aktiviteteve me qëllim afrimin e datës së fillimit të punimeve.

Në kuader të firmosjes paraprake të Marreveshjes së Investimit u organizuan një seri takimesh me përfaqësues të komunave fituese të projekteve për:

- Informimin dhe Sensibilizimin i Përfaqësuesve të Komunave mbi komponentët PUR.



- Diskutimin mbi pikat e Marrëveshjes Parapraketë Investimit.
- Procedurat e pagesës së Kontributit të Përfituesve.
- Firmosja e Marrëveshjes Paraprake të Investimit nga 24 Komunitet fituese të përzgjedhura nga studimi i fizibilitetit.

Gjatë tre-mujorit të fundit, u përgatitën njëkohësisht ToR dhe Dokumentat e Tenderit për firmat e Projektim-Supervizionit, u shpall ftesa për shprehje interesi për Firmat Projektuese. Me firmat projektuese ofertuese u zhvillua një konferencë për njohjen me dokumentat e tenderit. Fillorë fushata sensibilizuese dhe formimi i Grupevetë Ujit në terren në nivel komune dhe fshati. Komunitet Baz, dhe Qendër, të cilat kanë paraqitur probleme teknike/sociale dhe administrative në skemat e ujësjellesave u është dhënë asistencë e nevojshme nga stafi i FSHZH-së për zgjidhjen e këtyre problemeve.

### **Konkluzione:**

Projekti deri më sot ka respektuar afatet e realizimit të tij. Si pasojë e procedurave standarte të KfW-së, vecanërisht për prokurimet, ky projekt paraqet një kohezgjatje të konsiderueshme deri në fillimin e punimeve civile. FSHZH nëpërmjet negocimit me donatorin, si edhe nëpërmjet përmbylljes së shpejtë të etapave paraprake të seleksionimit dhe përgatitjes së dokumentacionit, po ben përpjekje ta avancojë këtë proces me synim fillimin sa më shpejtë punimeve publike.

### **2.4 Programi “Punëtnë Komunitet II” financuar nga Banka Botërore**

Viti 2009 ka qenë viti përmbyllës i nen-projekteve të mbetura nga faza e fundit e programit “Punet në Komunitet II”, si edhe për ndjekjen e fazës së garancisë për nënprojektet e realizuara gjatë vitit 2008. Nga 43 nënprojekte që kanë qenë pjesë e këtij Plani Pune, gjatë vitit 2009 janë marre përfundimisht në dorëzim 42 nënprojekte, 1 nënprojekt do të merret në dorëzim tre mujin e parë të vitit 2010. Projektet në fazën e garancisë janë kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme nga inspektorët teknikë për të verifikuar funksionimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Ajo që vëhet re është se realizimi teknik i nen-projektevetë infrastrukturës gjate programit “Punëtnë Komunitet II” ka qenë mjaft i kënaqshëm. Në të njëjtin nivel u paraqit edhe cilësia e projektimit, niveli i konkurrencës dhe transparencës në përzgjedhjen e firmave zbatuese dhe kujdesi për mbrojtjen e mjedisit gjate zbatimit të këtyre projekteve. Mjaft e kënaqshme paraqitet edhe situata e funksionimit dhe mirëmbajtjes së objekteve të cilat kanë dalë nga faza e garancisë.

Cilësia e realizimit dhe procedurat e ndjekura në funksionalitet të tij, kanë marrë vlerësime pozitive si nga misionet e BB ashtu edhe nga vlerësimet e brendshme dhe auditimet e jashtme teknike.

Zbatimi i projekteve të këtij plani pune tregoi një rritje cilësore të dukshme si në procedurat operacionale ashtu edhe në cilësi.

### **Konkluzion**

Projekti Punet në Komunitet II, vlerësohet i suksesshëm në të gjithë elementet përbërës të tij, duke përbushur objektivat kryesore për të cilat ai u financua. Vlerësimi përfundimtar i ardhur nga Banka Botërore (Shkurt 2009) e konsideron këtë projekt të

përmbyllur me sukses, dhe si një model që duhet ndjekur për sa i përket zbatimit të tij, por edhe impaktit që ka pasur. Realizimi i këtij projekti ka sjelle jo vetëm përmirësim të sistemit të infrastrukturës dhe shërbimeve në zonat ku ai është zbatuar, por edhe një angazhim maksimal të të gjithë aktoreve që kontribuan dhe përfituan në realizimin e tij, duke e bërë atë efektiv dhe të qëndrueshëm.

## **2.5 Programi i investimeve Qeveritare 2006-2009**

Një tjetër program investimesh i FSHZH-se është edhe realizimi i investimeve në infrastrukture të financuara nga Qeveria Shqiptare. Këto investime janë ndarë sipas viteve në katër grupe:

### **Projektet e financuara nga Buxheti i Shtetit gjatë vitit 2006 (GoA 2006)**

Nga Buxheti i Shtetit shtesë për vitin 2006 janë realizuar nga FSHZH gjithsej 11 nënprojekte. Nga këto 10 projekte kanë përfunduar periudhën e garancisë, ndërkohë gjatë vitit 2009 pritet që të mbyllet përfundimisht edhe një nënprojekt që është në periudhë garancie.

### **Projektet e financuara nga Buxheti i Shtetit gjatë vitit 2007 (GoA 2007)**

Në këtë program janë përfshirë 24 nën-projektetë cilat janë kontraktuar në fund të vitit 2007. Të gjitha projektet që kanë qenë në zbatim gjatë vitit 2008 janë mbyllur dhe kanë kaluar në periudhën e garancisë. Vlen të përmendet përfundimi në kohë dhe me cilësi të shumicës së projekteve. Gjatë vitit 2009 janë mbyllur përfundimisht 23 projekte dhe pritet që 1 projekt të mbyllet brenda tre-mujorit të parë të vitit 2010.

### **Projektet e financuara nga Buxheti i Shtetit gjatë vitit 2008 (GoA 2008)**

Në kuadër të fondeve të akorduara nga Buxheti i Shtetit për vitin 2008 për përmirësimin e infrastrukturës lokale në Njësitë e Qeverisjes Vendore, është miratuar financimi i 3 nën-projekteve në Qarqet e Shkodrës dhe atë të Vlorës. Punimet kanë përfunduar në të gjitha objektet dhe kanë kaluar në periudhën e garancisë.

### **Projektet e financuara nga Buxheti i Shtetit gjatë vitit 2009 (GoA 2009)**

Në kuadër të fondeve të akorduara nga Buxheti i shtetit për vitin 2009 për përmirësimin e infrastrukturës lokale në Njësitë e Qeverisjes Vendore, është miratuar financimi i i projektit: “Ndërtim ura e Lanes në Fshatin Mezez”, Komuna Kashar, Qarku Tirane, ku punimet kanë avancuar në masën 85 % si dhe “Ndërtimi i rruges në Lagjen Protoduar”, Komuna Poshnje Qarku Berat. Ky projekt ka përfunduar dhe është në garanci.

### **Konkluzione:**

Projektet e programit të investimeve të Qeverisë Shqiptare janë projekte të identifikuara në kuadër të programeve të tjera të FSHZH-se, bazuar në kriteret dhe standardet e

specifikuara në manualin e procedurave. Projektet kane pasur një ecuritë mirë dhe është synuar një implementim sa me i shpejt i këtyre projekteve duke synuar rritjen e impaktit si edhe shtimin e numrit të këtyre projekteve në vite.

## 2.6 Granti Konkurrues 2009

Edhe gjatë vitit 2009, FSHZH ka qenë e angazhuar për vlerësimin teknik të projekteve të Infrastrukturës lokale, në ndihme të Komitetit Ndërmintor të Shpërndarjes së Granteve Konkurruese .

Gjatë këtij viti janë kryer vleresimet tekniko-ekonomike në terren të kerkesave ardhur nga Ministria e Financave si dhe të vendimeve të Komitetit të Grantit Konkurrues për rreth 420 projekte, si dhe janë kontrolluar rreth 390 kërkesa për avancim financimi të paraqitura nga Njësitë e Qeverisjes Vendore për grantet që keto kanë perfituar nga Granti i vitit 2007, 2008 dhe 2009. Pas kontrollit dhe të pershtatshmerise së tyre sipas standardeve të Ministrisë së Financave, ky informacion i është percjellur kesaj Ministrie për të vazhduar me celjen e fondeve NjQV-ve përkatëse.

**Tabela 2.** Paraqitja e nënprojekteve sipas donatoreve dhe statusit të tyre Dhjetor 2009

Projekti	Donatori	Plani i Punës (PP)	Totali	Ne projektim	Ne tenderim	Ne kontraktim	Ne zbatim viti 2009	Përfunduar viti 2009	Ne Garanci	Mbyllur Përfundimisht në 2009
Punet në Komunitet II	IDA	PP2	43						1	42
Punet në Komunitet III	CEB	PPI & PPII & PP III	40	10			12		18	
GoA	GOA 2006	PP 1	11						1	10
	GOA 2007	PP 1	24						1	23
	GOA 2008	PP 1	3						3	
	GOA 2009	PP 1	2				1		1	
SIF (II & III)	KFW	PP 1	30						1	29
Rrugët Dytësore & Lokale		PP1 & PP2	29		3	4	22			
<b>TOTALI</b>			<b>182</b>	<b>10</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>35</b>		<b>26</b>	<b>104</b>

### 3. AKTIVITETI INSTITUCIONAL

#### 3.1 Menaxhimi Financiar

##### *Tiparet e përgjithshme të analizës financiare*

Paraqitja analizës financiare të vitit 2009 është bazuar në sistemin raportues të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, pasi metoda e raporteve të këtyre dy moduleve ndihmon në seleksionimin e atyre treguesve të cilët pasqyrojnë në mënyrë realiste performancën e institucionit. Kjo analize na jep informacion kryesisht mbi funksionet kryesore financiare: planifikimin (buxheti), kontabilitetin, menaxhimin financiar të investimeve dhe atë operativ-administrativ.

Gjate vitit 2009, janë bërë përpjekje për ruajtjen dhe garantimin e ekuilibrave financiarë të institucionit në mënyrë që i gjithë aktiviteti ekonomik - financiar i tij, të jetë i organizuar brenda limiteve të lejuara të financimit. Gjithashtu vëmendje i është kushtuar administrimit dhe menaxhimit të fondeve me përgjegjshmëri dhe transparence, si dhe monitorimit dhe mbikëqyrjes së detajuar të fondeve sipas komponenteve përkatës: investime infrastrukture, administrim të brendshëm, asistence teknike, etj.

Gjatë kësaj periudhe, FSHZH ka arritur një realizim financiar në vlerën 34,45 milion USD ose në masën 89% të buxhetit vjetor të rishikuar. Për sa i përket masës së realizimit vlen të theksohet se gjate vitit kemi dy etapa:

- i. periudhën e kryerjes së procedurës së prokurimit për kontratat e punimeve dhe
- ii. faza e implementimit.

Gjatë vitit 2009 FSHZH ka menaxhuar 54 kontrata për punime në infrastrukturë me vlerë rreth 71 milione USD nga të cilat, 42 kontrata me vlerë rreth 60 milionë USD, janë prokuruar dhe lidhur gjate vitit 2009. Për realizimin buxhetor janë ndjekur me përpikmëri plani vjetor i punës dhe procedurat e përcaktuara në marrëveshjet e nënshkruara me donatorët si dhe legjislacioni shqiptar.

Pasqyrat financiare, që paraqiten me poshtë, përmbajnë të dhëna progresive të cilat krijojnë një skenar të qarte të mjedisit ekonomik - financiar dhe të performances së aktivitetit të FSHZH-se gjatë kësaj periudhe, si dhe një analizë në nivelin strukturor të shpenzimeve dhe të të ardhurave duke paraqitur në këtë mënyrë raportin si edhe peshën specifike të kategorive dhe komponentëve të veçantë.

#### **Të ardhurat e FSHZH-se**

Gjatë vitit 2009, FSHZH ka menaxhuar fondet e akorduara nga donatorët e huaj dhe Qeveria Shqiptare në kuadër të 5 Programeve në zbatim si edhe fondet e kontributit të përfituesve të projekteve.

Aktualisht FSHZH ka në ndjekje financiare këto programe:

- Programi “Rrugët Dytësore dhe Lokale” – financuar Banka Botërore, OFID, Banka e Këshillit të Europës dhe Qeveria Shqiptare ;
- Programi “Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale – financuar nga KFW, Qeveria Shqiptare dhe përfituesit e drejtpërdrejtë;

- Programi “Punë tnë Komunitet III” - financuar nga CEB, Qeveria Shqiptare si dhe përfituesit drejtpërdrejtë;
- Programet “Fondi i Investimeve Sociale II dhe III” – financuar nga KfW, Qeveria Shqiptare dhe përfituesit drejtpërdrejtë;
- Programet e investimeve të financuara nga Buxheti i Shtetit gjatë viteve 2006, 2007, 2008 dhe 2009.
- Kontributi i komunave (përfituesit) në masën 10 % të vlerës së investimit si bashkëfinancim në projektet në zbatim që zbatojnë këtë kriter.

### **Disbursimi i Fondeve gjatë 9-mujorit 2009 sipas Programeve**

Gjatë këtij viti, në përputhje me kërkesat për financime, janë disbursuar nga donatorët e huaj rreth 21,63 milion \$ sipas Programeve si më poshtë:

- Për programin e Rrugëve Dytësore dhe Lokale gjate këtij viti janë disbursuar rreth 16,64 milion \$ nga të cilat IDA milion 5,13 USD, OPEC 4,50 milion \$, CEB 7 milion \$
- Për programin “Fondi i Investimeve Sociale II”- (Marreveshja Shtesë 216 mijë EUR) janë disbursuar 59 mijë \$.Ky është disbursimi i fundit per këtë program.
- Për programin “Furnizimi me ujë i zonave Rurale ”KFW IV janë disbursuar 533 mijë USD.
- “Projektin e Puneve në Komunitet –Faza III CEB)” janë disbursuar 4,40 milion USD.
- Fondet e akorduara në fillim viti nga Qeveria Shqiptare për të gjitha projektet në komponentët Investime, Kosto Lokale dhe TVSH janë në vlerën 8,88 milion USD. Në muajin Tetor 2009 ky fond u rishikua në ulje me vleren 1,1 milion USD.
- Kontributi i perfituesit për Projektet e Punëve në komunitet II dhe Furnizimin Rural me Ujë është arketuar në vlerën 1.38 milionë \$.

### **Të ardhura të tjera**

Gjatë aktivitetit ekonomiko-financiar të tij, FSHZH realizon hyrje të vlerave monetare (tëardhura) në vlera të pakta nga aktivitetet dytesore si: shitje të dokumentave të tenderave, investime të likujditeteve në lekë (vendosje depozite me afat), të ardhura per sherbime të kryera nga institucioni si seleksionimi i projekteve për Grantet konkurruese, etj.


Gjatë këtij viti janë vendosur depozita me afat, 3 mujor dhe 6 mujor për fondet në lekë përkohësisht të lira duke u ndjekur procedurat e percaktura në Vendimin e Komitetit Ekzekutiv për përzgjedhjen e ofertes më të mire ofruar nga Bankat të cilat operojnë sot në treg.

Të ardhurat për këtë 9-mujor për këto zëra janë si më poshtë:

- Të ardhura nga Grantet Konkurruese – 28,665 USD
- Të ardhura nga shitja e dokumentave për tender – 41,452 USD
- Të ardhurat nga Interesat e Depozitave –150,495 USD

## Shpenzimet dhe Realizimi i Zërave të Buxhetit për 9 mujorin e vitit 2009

Gjatë këtij viti FSHZH ka menaxhuar një fond prej 34,4 milion US\$, me një realizim financiar në masën 89 % të buxhetit vjetor 2009. Realizimi financiar paraqitet meë poshtë i ndare sipas komponentëve respektivë.




### Infrastruktura

Ky zë përben aktivitetin kryesor të Institucionit dhe përfaqëson investimet në infrastrukture për rrugë, shkolla, qendra komunitare dhe projekte të zhvillimit lokal. Si komponent është realizuar në një vlerë prej 29,54 milion USD ose në masën prej 91 % kundrejt buxhetit vjetor. (Tabela bashkëngjitur “Realizimi i zërave të Buxhetit për vitin 2009”). Vlen të theksohet që Projekti i Rrugeve Lokale dhe Dytësore zë rreth 51 % të buxhetit të realizuar në këtë kategori.

Tabela 3. Realizimi financiar gjatë vitit 2009 për kategorinë “Investime”

Programet	Realizimi në % kundrejt buxhetit vjetor 2009	Realizimi në vlere (shprehur në USD)
Investime Qeveria Shqiptare+TVSH	97%	6,907,088
Përfituesit	100%	764,644
Punët në Komunitet III(CEB)	100%	6,700,511
Fondi i Investimeve Sociale II, III,IV	100%	47,535
Rrugët Dytësore dhe Lokale	85%	15,076,393
Fonde të Veta	86%	47,689
<b>Totali</b>	<b>91%</b>	<b>29,543,860</b>



### Projektim Supervizioni

Ky zë është realizuar në vlerën 1,35 milion USD ose në një masë prej 82 % kundrejt Buxhetit vjetor 2009 (Aneksi 2).

Pjesën më të madhë të këtij komponenti e zenë shpenzimet për kontratën e supervizionit me kompaninë Louis Berger e cila kryen supervizionin e punimeve në kuadër të Projektit të Rrugëve Dytësore & Lokale, në vlerën 1,04 milione USD.

Në këtë zë përfshihen të gjitha likuidimet e kryera në favor të kontraktorëve për projektimin e objekteve të reja si dhe për supervizionin e objekteve që janë në zbatim dhe në përfundim të punimeve.

### Asistenca Teknike

Ky komponent është realizuar në vlerën 1,39 milion USD ose në një masë prej 75 % kundrejt Buxhetit vjetor 2009 dhe përfshin konsulencë të huaj në kuadër të Projektit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale në vlerën 546 mijë USD, në kuadër të Projektit të Furnizimit me Ujë –KFW në vlerën 533 mijë USD, si dhe konsulencë lokale për trajnimin e NjQV-ve, në kuadër të hartimit të PZhL-ve si pjesë e Programit “Punët në Komunitetin III”, CEB Grant në vlerën 132 mijë USD.

### Kualifikime

Ky komponent përfshin shpenzimet e kryera për kualifikimin e stafit të FSHZH-se dhe ë Komunave dhe Bashkive në përputhje me buxhetin e aprovuar. Ky zë është realizuar në vlerën 170 mijë USD ose në masën 78 % të buxhetit vjetor. Trainimet kanë qenë të natyrës individuale dmth 1 ose 2 persona në një temë të caktuar si edhe trainime në grup. Për vitin 2009 trajnimet kanë qenë si më poshtë:

- Trajnim për menaxhimin e kontratave FIDIC. Ky trainim është realizuar për të gjithë stafin inxhinierik dhe të tjere që kane lidhje me menaxhimin e kontratave, dhe u realizua në ambientet e FSHZH-së prej specialisteve të FIDIC.
- Trajnim për manaxhim financiar dhe për procedurat e manaxhimit dhe implementimit të fondeve të IPA-s.
- Menaxhimi i projekteve të zhvillimit.
- Zhvillimi ekonomik lokal.
- Trajnim mbi Monitorim – Vleresimin e Programeve Nderkombetare, dhe Politikave Publike: Ulja e Varferise, Politikat Sociale, dhe Garantimi i shërbimeve publike.
- Study tour me punonjësit e Qeverisjes Vendore për njohjen me mënyrat dhe instrumentet e promovimit të turizmit nga ana e Njësive të Qeverisjes Vendore Poloni & Kroaci.
- Study tour në Greqi dhe France i stafit të departamentit të infrastruktures për tu njohur me standardet dhe teknologjitë e reja të aplikuara në ndërtimin e infrastruktures.
- Cikel trajnimesh për ngritjen e kapaciteteve të pushtetit lokal për funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor të rrugëve rurale. Etj.

## Pajisje

Ky zë është realizuar në vlerën 362 mijë USD ose 58 % kundrejt buxhetit. Realizimi i kësaj kategorie në këtë mase ka ardhur si rezultat i mos kryerjes së pagesës për blerjen e dy automjeteve, pajisjeve kompjuterike për të cilat procedura prokurimit është kryer gjatë tre-mujorit të fundit 2009 dhe pagesat do të bëhen gjatë vitit 2010.

## Shpenzime operative

Shpenzimet operative janë realizuar në vlerën 86 % kundrejt buxhetit vjetor. Me gjithë trendin në rritje të investimeve, FSHZH ka menaxhuar me efektivitet cdo zë të shpenzimeve operative dhe pesha specifike e koston kundrejt investimit është në masen 5,5 % ndërsa kundrejt buxhetit total 4.7 %.

Kosto operative e vitit 2009 është parashikuar rreth 170 milion Lekë dhe është realizuar në vlerën 147 milionë lekë ose në masën 86 % e ndarë sipas nën-kategorive të mëposhtme:

### a. Shpenzimet për kancelari

Për vitin 2009 shpenzimet për kancelari janë parashikuar në një vlerë prej 2 milion lekë dhe janë realizuar 97 % të shumës së buxhetuar. Shpenzimet kryesore në këtë zë janë kryesisht për kancelari të ndryshme, letër, bojëra për fotokopje dhe printera, mirembajtje të paisjeve kompjuterike, fotokopjeve, etj.

### b. Shpenzimet për karburant

Buxheti vjetor i parashikuar për këtë zë të shpenzimeve është 9 milion leke, ose 5.28 % të buxhetit vjetor të koston operative. Ky zë është realizuar në masen 72 % ose në



vleren 6,45 milion lekë. Aktivitetet dhe levizjet në terren janë koordinuar me efikasitet midis departamenteve duke sjellë një ulje të shpenzimeve për këtë zë.

c. Shpenzimet për mirëmbajtjen dhe siguracion të automjeteve

Keto shpenzime përfshijnë shërbimet periodike, shërbimet e veçanta, blerjen e pjesëve të kembimit, gomave dhe siguracionin e mjeteve. Buxheti i parashikuar për këtë zë është rreth 4 milion lekë, realizimi vjetor është rreth 3,98 milionë lekë nga të cilat 1,10 milionë lekë janë shpenzuar për siguracion Kasko & TPL ..

d. Shpenzimet për paga, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore për vitin 2009 janë parashikuar në shumën 126 milionë lekë. Ky zë është realizuar në masën 90 %.

e. Shpenzimet për dieta e shërbime

Shpenzimet për dieta dhe shërbime për vitin 2009 janë parashikuar në masën 9 milionë lekë. Ky zë shpenzimesh është realizuar në vlerën 6.54 milionë lekë ose 73 % ndaj shumës së buxhetuar. Ky zë shpenzimesh mbështet kryesisht aktivitetin e kryer nga Departamenti i Infrastrukturës për mbikqyrjen e objekteve në terren dhe tendenca gjatë periudhës në vazhdim do të jete në rritje si rezultat i rritjes së volumit të punës. Edhe për tekete ze ka pasur një koordinim të aktiviteteve dhe levizjeve në terren, duke ulje të shpenzimeve.

f. Shpenzimet e komunikimit

Në këtë zë ku përfshihen shpenzimet për komunikim si edhe shpenzimet e shërbimit postar në total janë parashikuar rreth 5 milionë lekë për vitin 2009. Ky zë është realizuar në vlerën 4 milion leke ose 80 % kundrejt buxhetit vjetor. Këto shpenzime janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me shpenzimet e tjera të aktivitetit në terren, pasi rritja e volumit të punës çon automatikisht në një shtim të nevojës për komunikim me partneret lokalë dhe kontraktoret në funksion të realizimit të projekteve. Për sa me sipër është parashikuar vënia në efikasitet të këtyre fondeve.

g. Shpenzimet tjera

Për këtë zë në buxhetin 2009 janë parashikuar rreth 12,70 milionë lekë. Ky zë është realizuar në vlerën 9,46 milionë lekë ose 74.5 %.

Në zërin shpenzime të tjera përfshihen shërbimi i internetit, facilitete rajonale të FSHZH-se, shpenzime për energji elektrike, uje, ruajtje e godinës, mirëmbajtje e sistemeve të zyrave qendrore, siguracione, seminare të stafit, utilitete të ndryshme, blerje të vogla etj.

h. Publikime & Promovime

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për reklama, spote publicitare e televizive, publikime të ndryshme në kuader të promovimit të punës dhe imazhit të institucionit. Për këtë zë në buxhetin 2009 janë parashikuar rreth 2.56 milionë lekë dhe realizimi i këtij zeri është në vlerën 541 mijë lekë ose 21 % e buxhetit të miratuar. Realizimi financiar është më i

ulet se realizimi faktik i materialeve publicitare të botuara. Arsyeja kryesore e kesaj mospërputhje është fakti i realizimit të materialeve promovuese në fund të dhjetorit. Si rezultat pagesa do te behet dhe perfshihet ne buxhetin e 2010.

**Tabela 4.** Realizimi i shpenzimeve operative kundrejt buxhetit vjetor 2009  
*Analiza e shpenzimevetë kostos operative*

(LEKE)

No	ZERAT	Buxheti vjetor 2009	Realizimi 2009	Realiziminë % kundrejt buxhetit vjetor
1	Kanceleri	2,000,000	1,937,078	97%
2	Karburant	9,000,000	6,458,333	72%
3	Servis makinash/siguracion	4,000,000	3,982,025	100%
4	Pagat	126,000,000	113,409,656	90%
5	Dieta	9,000,000	6,539,801	73%
6	Telefon dhe PT	5,000,000	4,009,282	80%
7	Internet	1,000,000	631,836	63%
8	Energji Elektrike/Uje	1,200,000	1,070,967	89%
9	Zyra me qera	1,200,000	788,825	66%
10	Mirembajtje/Sigurim godine	2,000,000	1,712,783	86%
11	Te tjera/Petty cash	7,300,000	5,257,761	72%
12	Publikimi & Promovime	2,560,000	541,904	21%
13	bank charges		1,344,274	
	<b>TOTAL</b>	<b>170,260,000</b>	<b>147,684,525</b>	<b>86%</b>

### 3.2 Komunikimi dhe Informimi

Një punë progresive është kryer në drejtim të konsolidimit të sistemit të informimit dhe komunikimit me publikun. Gjate vitit, është punuar për zgjerimin e kontakteve me publikun, rritjen e transparencës mbi aktivitetet e kryera si edhe shtimit të konsultimeve publike në kuadër të programeve specifike. Një sërë artikujsh janë botuar në median e shkruar si gazetat Panorama, Standart, Shqip, Shekulli, revista Monitor etj, ku është paraqitur aktiviteti kryesor i FSHZH-së, ecuria e programeve individuale si edhe arritjet e deritanishme. Gjithashtu janë paraqitur kronika televizive në mediat kombëtare dhe lokale si TVSH, TV Klan, News 24, Ora News, mbi projektet që po zbatohen si edhe të impaktit që ato do të kenë pas përfundimit. Është punuar gjithashtu për ngritjen e një rrjeti me kontakte mediatike lokale me synim informimin në kohë reale të komuniteteve lokale përfituese.

Ka vazhduar publikimi në faqen e internetit i të gjitha lajmeve, njoftimeve dhe prokurimeve të cilat janë zhvilluar gjate kësaj periudhe, si edhe ka pasur një ndërveprim aktiv në faqen e internetit përse i përket aktiviteteve të zhvilluara në kuadër të Programit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale.

Gjate muajve Janar-Shkurt u përfundua plani i punës për aktivitetet informative dhe publikimit që lidhen me te. Në muajin Mars u kryen prokurimet për shërbimet e dizajnit dhe publikimit të materialeve për këtë vit. Në muajin Qershor filloi prodhimi i materialeve të para informative si edhe një broshurë informative mbi aktivitetin e përgjithshëm të FSHZH-së si edhe për programet individuale.

### 3.3 Monitorimi dhe Vlerësimi

Një ndër kapacitetet e ngritura pranë FSHZH-së dhe që po merr rendësi të veçante gjatë zbatimit të programeve të fundit është Monitorimi dhe Vlerësimi i programeve. Ngritja e kapaciteteve dhe integrimi i këtij komponenti gjatë gjithë ciklit të projektit ka qenë në fokusin e aktivitetit të institucionit. Gjate vitit 2009 është punuar për vënien në eficence të plote të sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të performancës së programeve. Duke u nisur edhe nga pesha specifike e programeve në zbatim, aktiviteti i mësipërm ka nisur me programin e “Rrugëve Dytësore dhe Lokale”.

Në periudhën Janar-Prill u krye një studim i hollësishëm i programit, marrëveshjeve, termave të referencës, planeve të punës si edhe të detyrave specifike të të gjithë aktoreve të përfshirë në program. Qëllimi i monitorimit ka qenë analizimi i ecurisë së projektit në komponentet kryesore të tij, duke evidentuar problematikat e hasura në të gjithë ciklin e projektit dhe propozimi i përmirësimeve të nevojshme për korrigjimin e tyre, duke synuar një performancë të kuadruar brenda objektivave të zhvillimit të programit. Gjatë gjithë vitit ky monitorim u shtri edhe në terren duke vizituar pjesën më të madhe të objekteve në zbatim. Në muajin Korrik u hartua edhe raporti i parë periodik i monitorimit dhe vlerësimit të performancës të Programit “Rrugët Dytësore & Lokale”, për periudhën Maj 2008-Qershor 2009. Raporti përfaqëson një analizë të performancës së programit në të gjithë komponentet e tij, me synim evidentimin e arritjeve dhe problematikave të hasura nga fillimi i programit deri në Qershor 2009.

Në raport jepen dhe një seri rekomandimesh në funksion të përmirësimit të performancës së programit. Vlen për tu përmendur fakti i efikasitetit të këtij mekanizmi të ri institucional dhe reflektimit të menjehershëm të kryer nga departamentet e angazhuara në implementimin e programit vecanerisht :

- Përfshirja e PMZM dhe menaxhimit të trafikut në raportet periodike të Supervizorit. (Qershor 2009).
- Kualifikimi i stafit të FSHZH, për njohjen dhe zbatimin e kontratave sipas kushteve të FIDIC. (Korrik 2009).
- Marrja e masave për kryerjen e operimeve të projektimit.
- Dhenia e më shumë kompetencave Inspektoreve teknike në terren.

Ka vijuar puna për përcaktimin e metodologjisë dhe mbledhjes së të dhënave për monitorimin e Programit të Ujesjellesve Rurale, dhe “Punëtnë Komunitet III”.

Njëkohësisht është punuar për përzgjedhjen e indikatorëve sasiore dhe cilësore për base-line në kuadër të studimit për vlerësimin e impaktit për dy projektet e sipër përmendura.

Gjatë muajit, Korrik janë përgatitur informacione dhe janë asistuar misionet e donatoreve të ardhura për vlerësimin e programeve SIF II, SIF III, CWP II.

Në bashkëpunim me sektorin e informatikës, është punuar për konceptimin dhe ngritjen e një baze të dhënash në GIS. Për këtë janë hedhur idetë e përgjithshme dhe janë duke

u diskutuar mjetet dhe format e përdorimit të këtij aplikacioni. Janë marre kontakte me disa operatore GIS dhe INSTAT për të pare nga afër variante të ndryshme aplikimi.

### **3.4 Auditimi i brendshëm**

Njësia e Auditimit të Brendshëm, ka zhvilluar aktivitetin e saj për vitin 2009, bazuar në planin vjetor të auditimit, si dhe në programet e aprovuara për çdo auditim të realizuar. Programet janë hartuar bazuar në objektivat e FSHZH të përcaktuara për fazat e implementimit të projekteve, metodën e vlerësimit të riskut për projektet dhe strukturat e përfshira në to si dhe misionin e auditit të brendshëm. Aktiviteti i kësaj njësie ofron një siguri objektive në funksionimin dhe efencën e sistemit të brendshëm të kontrollit në funksion të realizimit të objektivave, në përputhje të plotë me ligjet dhe rregullat e përcaktuara për financimet e huaja në Shqipëri.

#### **3.4.1 Qëllimi i Auditimit të Brendshëm.**

Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm është hartuar dhe zhvilluar për arritjen e qëllimeve të mëposhtme:

- Të ofrojë siguri të arsyeshme mbi menaxhimin dhe përdorimin e fondeve publike me transparence, eficence dhe efektivitet si dhe implementimin e programeve realizohen konform marrëveshjeve të financimit, Manualit të procedurave, Marrëveshjeve të financimit si dhe ligjeve e rregullave të përcaktuara.
- Të monitorojë dhe vlerësojë mjaftueshmerinë dhe efencën e sistemit të kontrollit të brendshëm, nëse procedurat, rregullat e praktikat e vendosura për implementimin e projektit siguron shmangien e gabimeve materiale, abuzimeve e mashtrimeve të mundshme si dhe realizmin e plote të objektivave dhe të kontribuojë në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
- Të ofrojë siguri të arsyeshme se risqet e organizatës janë menaxhuar me efektivitet dhe qëllimet dhe objektivat e përcaktuara nga Fondi, do të arrihen në mënyre efektive dhe ekonomike.
- Të kontribuojë në përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të riskut dhe kontrollit përmes identifikimit dhe vlerësimit të ekspozimeve ë dukshme të rrezikut, vlerësimin e menaxhimin e risqeve e të dobësive në kuadrin e arritjes së objektivave për të ardhmen.
- Të raportojë mbi veprimet korrigjuese të ndërmarra nga të gjitha strukturat e Fondit.

#### **3.4.2 Auditimetë realizuara gjate vitit 2009**

Njësia e Auditimit të Brendshëm, gjate vitit 2009 ka realizuar 10 misione auditimi. Temat e auditimit si dhe projektet e audituara janë :

1. Auditim i plotë vlerësues tekniko - financiar për nënprojekte te financuara nga Qeveria Shqiptare .
2. Auditim i plotë vleresimi tekniko-financiar i projektit “Punet në Komunitet III” financiar nga CEB.
3. Auditim i fazës së funksionin- mirëmbajtjes së projekti t“ Punët në Komunitet II” .

4. Auditim i fazës së Zbatimit teknik të punimeve civile në projektin Rrugët Dytësore dhe Lokale’ .
5. Auditim i funksionimit të sistemit të raportimit dhe Informacionit pranë FSHZH.
6. Auditimi mbi funksionimin e sistemit financiar të përgatitjes së pasqyrave të fundvitit financiar në përputhje me standarde kombëtare të kontabilitetit.
7. Auditim i sistemit të kontrollit financiar mbi shpenzimet administrative të kryera nga cash-i si dhe letrave me vlere( karburantit).
8. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të NJAB të lëna mbi “Auditimin i sistemit të kontrollit financiar mbi shpenzimet administrative të kryera nga cash-i si dhe letrave me vlere( karburantit).
9. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të NJAB të lëna mbi “Auditim i fazës së Zbatimit teknik të punimeve civile në projektin Rrugët Sekondare dhe Lokale’.
10. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të NJAB të lëna mbi “Auditim i plotë vlerësues tekniko - financiar për nënprojekte e financuar nga Qeveria Shqiptare .

### **Opinionit e auditimit**

Në auditimet e realizuara gjatë vitit, ndër të cilat: i) auditim i plotë mbi projektet e financuara nga Qeveria Shqiptare si dhe projektet e financuar nga CEB , ii) mbi fazën e zbatimit të punimeve për projektin e Rrugëve Dytësore dhe Lokale si dhe iii) fazën e funksionim mirëmbajtjes për projektet e financuara nga IDA, vi) auditimi i plotë i sistemit të informacionit dhe raportimit të projekteve u konstatua :

- Paraqitje pozitive e performances së punonjësve të FSHZH, në respektim të kërkesave të Manualit të Procedurave, kritereve të marrëveshjeve të financimit si dhe legjislacionin në fuqi lidhur me disiplinën financiare si dhe kontrollin dhe disiplinën e punimeve të ndërtimit.
- Në Departamentin e financës është vendosur dhe funksionon rregullisht sistemi i kontrollit të dyfishtë të operacioneve që kryhen në këtë departament. Softi i kontabilitetit, ku aplikohen siguron saktësinë dhe plotësinë e regjistrave kontabël, të paraqitur në dy monedha baze, duke dhënë siguri të arsyeshme mbi raportimet financiare në plotësim të standarteve dhe kërkesave të donatoreve si dhe Qeverisë Shqiptare.
- Ka ndarje të qarte të detyrave dhe përgjegjësive për personat që merren me nxjerrjen e urdhrave e vendimeve, regjistrimin e operacioneve dhe ruajtjen e vlerave.
- Departamenti i Infrastrukturës, ka përmirësime të ndjeshme në drejtim të plotësimin të dokumentacionit teknik e financiar të nënprojekteve si edhe ka bere ecuri të dukshme në drejtim të koordinimit e bashkëpunimit me projektues, supervizore, për ndjekjen e plote dhe të vazhdueshme të disiplinës dhe cilësisë së punimeve të ndërtimit.
- Sigurohet ndjekje e kontrolli i plote dhe i vazhdueshem i ecurisë dhe cilësisë së punimeve në objekte. Në mënyre të veçante vërehet performance mjaft e mire në implementimin e projektit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale.
- Sistemi i informacionit dhe raportimit të projekteve, është ngritur dhe funksionin normalisht në drejtim të sigurimit të raportimeve të sakta dhe të shpejta e në plotësim të standardeve të kërkuara për të gjitha projektet në implementim si dhe në mënyre të integruar për FSHZH. Funksionin softi i kontabilitetit FMS (Finance management system) i cili siguron raportimin financiar sipas standardeve

ndërkombëtare të raportimit, brenda afateve të kërkuara nga donatorët si dhe MIS (Management Information System) i cili funksionon në departamentin e Infrastrukturës dhe jep informacion dhe raportime mbi ecurinë teknike të projekteve.

- Strukturat e Fondit janë në gjendje të shkëmbejnë ndërmjet tyre informacionin e nevojshëm për të menaxhuar ecurinë e ciklit të projekteve sistemit të informacionit dhe raportimit, duke i dhënë me shume vlere informacionit.
- Është siguruar marrëdhënia institucionale dhe transparente me NjQV-te përfituese të projekteve veçanërisht lidhur me bashkëfinancimin në projekte si dhe prokurimin dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit.

Në raportet e auditimit është vlerësuar performanca e mirë e stafit në realizimin e projekteve si dhe janë konstatuar pamjaftueshmëri të elementeve të veçante të sistemit të kontrollit brendshëm teknik e financiar si dhe shkelje të disiplinës dhe kontrollit të punimeve të ndërtimit. Për të gjitha mangësitë dhe shkeljet e disiplinës financiare dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit të konstatuara, nga auditorët, janë dhënë gjithsej 65 rekomandime, të ndara si vijon:

- 50 rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrollit brendshëm teknik e financiar,
- 7 rekomandime janë mbi rregullsinë e dokumentacionit dhe praktikave të punës
- 8 rekomandime janë masa zhdëmtimi.

Rekomandimet kanë synuar në përmirësimet që duhen bërë në elementë të veçantë të : Manualit të Procedurave drejtuese, administrative, financiare dhe teknike të FZSHH-së, Marrëveshjeve të Financimit, të strukturës organizative të FSHZH-së, të rregulloreve dhe praktikave të punës për forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm teknik dhe financiar, të sistemit të informacionit dhe raportimit të projekteve, të ngritjes së kapaciteteve profesionale të stafit.

Konkluzionet dhe rekomandimet e Njesisë së Auditimit janë prezantuar dhe diskutuar me strukturat e FSHZH, ku është paraqitur edhe risku që paraqesin këto mangësi në cilësinë dhe punimeve dhe në arritjen e objektivave të Fondit.

Raportet e auditimit janë miratuar të gjitha nga Drejtori Ekzekutiv, dhe për çdo raport është nxjerre Urdher i Brendshëm, mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Në zbatim të rekomandimeve të lëna nga ana e strukturave të Fondit është përgatitur plani i veprimit, duke reflektuar një impenjim të plotë të tyre për korrigjimin e mangësive të konstatuara dhe konsolidimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

## 4. AKTIVITETE TE TJERA

### 4.1 Miratimi i ligjit për Fondin Shqiptarë Zhvillimit

Në vijim të procedurave për miratimin e projekt-ligjit për rregullimin e statusit ligjor të FSHZH-së bazuar në vendimin nr. 66 të Bordit Drejtues, më datë 11.05.2009, u miratua në Kuvendin e Shqipërisë ligji nr. 10130, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit". Me Dekretin nr.6181, datë 25.05.2009, Presidenti i Republikës ka dekretuar shpalljen e këtij ligji dhe më datë 12.06.2009, ligji nr. 10130, datë 11.05.2009, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", është botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Për sa më sipër ky ligj ka hyre në fuqi më datë 27.06.2009.

Ky ligj rikonfirmon statusin juridik të FSHZH-së si një organizatë jo fitimprurëse me personalitet juridik që *përcaktohet me ligj të veçantë, si e vetmja mundësi ligjore për të ruajtur të njëjtin status juridik për FSHZH-në*. Përcaktimi me ligj të veçantë i statusit juridik të FSHZH-së rregullon në mënyrë përfundimtare dhe të qëndrueshme funksionimin e saj si dhe forcon e garanton rolin e FSHZH-së si një organizëm i specializuar i shtetit shqiptar në zbatimin e projekteve të zhvillimit. Ligji i miratuar ka si qëllim rregullimin e statusit ligjor të FSHZH-së në mënyrë të qartë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky ligj konfirmon krijimin, organizimin dhe funksionimin e FSHZH-së si një person juridik me statusin e organizatës jo-fitimprurëse, duke sanksionuar kështu një status ligjor të FSHZH-së, si dhe duke përcaktuar organet drejtuese, fushën e veprimtarisë, qëllimin dhe objektivat, parimet e veprimtarisë, kapitalin dhe burimet e financimit, drejtimin dhe menaxhimin, kufizimet dhe kërkesat specifike të saj.

Nisur nga eksperiencia ndërkombëtare në krijimin dhe funksionimin e organizmave të ngjashëm me FSHZH-në si dhe me historikun dhe funksionimin e saj që nga viti 1993, ligji ka pasur parasysh ruajtjen e qëllimit dhe objektiveve të krijimit të FSHZH-së, si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të saj, duke siguruar në këtë mënyrë nga njëra anë pavarësinë operacionale dhe financiare të FSHZH-së dhe nga ana tjetër besueshmërinë e tij kundrejt institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare.

### 4.2 Misioni i Vlerësimit të Bankës Botërore për programin "Rrugët Dytësore dhe Lokale"

Një mision i Bankës Botërore vizitoi Shqipërinë në muajin Shtator për supervizionin e zbatimit të programit të "Rrugëve Dytësore dhe Lokale". Objektivat kryesorë të këtij misioni ishin: (i) konfirmimi i situatës aktuale të komponentëve të projektit, përfshirë mallrat, punimet civile dhe kontratën e supervizionit (ii) të konfirmoje implementimin kënaqshëm të mbrojtjes sociale dhe ambientale (iii) të rifreskoje indikatorët e performances së projektit. (iv) realizimi i vizitave në terren si të nevojshme për të parë nga afër implementimin e punimeve civile (v) rishikimin e statusit të prokurimeve, detyrimeve të palëve dhe progresin e arritur në përmbushjen e kërkesave të projektit.

Në përfundim të këtij vlerësimi, Misioni i BB, konstatoi se:

- Implementimi i projektit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale është duke avancuar shumë mirë, me punimet që avancojnë mirë në të njëmbëdhjete kontratat e punimeve civile të Rrugëve Dytësore dhe Lokale.
- Përgatitja e projektit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale ka përfshirë brenda tij dhe hartimin e një program me të gjere, duke pasur një mbështetje me financime dhe interes sinjifikativ nga donatorët tjerë.

#### **4.3 Misioni i Vlerësimit për "Punët në Komunitet I dhe II"**

Një mision i përberë nga specialistë të zyrave të vlerësimit të BB, CEB dhe KfW, vizituan FSHZH-në, në periudhën Korrik-Gusht, për të grumbulluar informacion mbi hartimin e Raportit të vlerësimit të performances së projekteve "Punët në Komunitet I dhe II".

Objektiv i misionit ishte vlerësimi i rezultateve të arritura nga projektet dhe eksperiencës së përftuar prej tyre, përfshirë edhe ceshtje të lidhura me hartimin dhe implementimin e projekteve. Një element i rëndësishëm i këtij misioni ishte edhe konsultimi i opinioneve të agjencise zbatuese si edhe të përfituesve. Qëllimi i hartimit të këtij raporti është nxjerrja e mesimeve nga keto eksperiencia, demonstrimi i besueshmërisë në disbursimin e fondeve të projekteve, si edhe kontribut në përpjekjet e vazhdueshme të BB për të përmirësuar asistencën teknike që ajo ofron. Misioni bëri vizita në terren në qarqet Tiranë, Durrës, Shkodër, Dibër dhe Fier ku u njoh së afërmi me nën-projektet e realizuara, si edhe pati takime me përfaqësues të qeverisjes vendore dhe të komunitetit përfitues. Së shpejti pritet që të dali draft raporti i vlerësimit të performances së projekteve "Punët në Komunitet I dhe II".

#### **4.4 Misioni i vlerësimit të KfW-së për programin "Furnizimi me Ujë i Zonave Rurale"**

Një mision i KfW-se vizitoi Shqipërinë në datat 27-28 Qershor, me qëllim vlerësimin e ecurisë së programit të "Ujësullësve Rurale", financuar në kuadër të programit të kooperimit Shqiptaro-Gjerman. Gjate takimeve të kryera me stafin e FSHZH-së u diskutua mbi aktivitetet e kryera, problemet e dala dhe hapat e mëtejshëm që do të ndërmerren për realizimin e këtij programi. Në mbyllje të kësaj vizite, misioni vlerësoi se Projekti ka bërë progres dhe përmirësime thelbësore, megjithatë ka ende punë për tu bërë në zhvillimin e konceptit të funksionimit dhe mirëmbajtjes si edhe në ristrukturimin e sektorit të ujësullësve rurale.



## 5. ANEKSE

- 5.1 Informacion mbi nën-projektet e programit “Punët në komunitet III”
- 5.2 Informacion mbi nën-projektet e programit “Rruget Dytesore & Lokale”, financuar nga Banka Boterore (IDA)
- 5.3 Informacion mbi nën-projektet e programit “Rruget Dytesore & Lokale”, financuar nga OFID
- 5.4 Informacion mbi nën-projektet e programit “Rruget Dytesore & Lokale”, financuar nga Banka e Keshillit të Europes (CEB)
- 5.5 Tabela e Skemave të ujësjellësve fizibel, programi “Ujësjellësit Rurale”
- 5.6 Realizimi i zërave të buxhetit për vitin 2009 (sipas donatoreve)
- 5.7 Shpenzimet sipas Donatoreve dhe Kategorive për vitin 2009
- 5.8 Projekte në implementim gjate nëntëmujorit 2009

## 5.1 Informacion mbi nen-projektet e programit “Punëtnë komunitet III”

(Dhjetor 2009)

NR	QARKU	RRETHI	KOMUNA / BASHKIA	LLOJI I PROJEKTIT	DONATORI	GJATESIA E INVESTIMIT (Km)	DATA E FILLIMIT	DATA E MBARIMIT	% REALIZIMIT TEKNIK	% REALIZIMIT FINANCIAR	Faza
1	Berat	Berat	Kutalli	Rikonstruksioni I rruges Kutalli - Samatice- Gorican	CEB	1.5	5-01-2009	5-07-2009	100%	92%	I
2	Berat	Berat	Kutalli	Vazhdimi I rruges Kutalli - Drenovice	CEB	2.7	22-06-2009	22-11-2009	100%	92%	II
3	Diber	Mat	Ulez	Sistemim I qytetit Ulez (Ujesjelles + Grope Septike	CEB	9.4	22-06-2009	22-12-2009	98%	74%	I
4	Durres	Durres	Ishem	Rikonstruksioni I rruges Fushe Drac - Drac	CEB	2.8	5-06-2009	5-12-2009	100%	80%	I
5	Durres	Durres	Rrashbull	Rruga e lagjes Shkozenë fshatin Shen Avlash	CEB	1.0	26-03-2009	26-09-2009	100%	92%	I
6	Durres	Durres	Rrashbull	Sistemim Asfaltimi I rrugëve të brendshme të zonës së banuar Shkëmbi I Kavajës	CEB	1.5	14-12-2009	14-07-2009	0%	0%	II
7	Elbasan	Elbasan	Tregan	Rikonstruksioni dhe asfaltim I rruges Lixhat e Idrait	CEB	0.8	30-12-2008	30-06-2009	100%	91%	I
8	Elbasan	Elbasan	Tregan	Sistemim asfaltim I rruges së fshatit Tregan	CEB	1.96	11-06-2009	21-10-2009	100%	92%	II
9	Fier	Fier	Dermentas	Rikonstruksion I rruges së fshatit Darezeze	CEB	0.8	25-01-2009	25-06-2009	100%	91%	I
10	Fier	Fier	Dermentas	Asfaltimi I rruges Hoxhare - Darezeze	CEB	9.2	2-09-2009	2-03-2010	42%	48%	II
11	Gjirokaster	Permet	Petran	Asfaltim I rruges së fshatit Bodar	CEB	2.7	5-01-2009	5-07-2009	100%	92%	I
12	Gjirokaster	Permet	Petran	Rikonstruksioni I rruges së Benjes	CEB	6.5	27-07-2009	27-06-2010	25%	18%	II
13	Kukes	Tropoje	Margegaj	Asfaltimi I rruges së fshatit Shoshan	CEB	1.6	7-01-2009	7-06-2009	100%	86%	I
14	Kukes	Tropoje	Margegaj	Rikonstruksioni I rruges Kocanaj	CEB	1.7	22-09-2009	27-01-2010	40%	26%	II
15	Korce	Korce	Drenove	Rikonstruksioni I rrugëve të brendshme të fshatit Mborje	CEB	0.5	30-12-2008	20-06-2009	100%	92%	I
16	Korce	Korce	Drenove	Rrjeti shpërndarës I fshatit Boboshtice	CEB	10.4	25-06-2009	1-11-2009	100%	92%	II
17	Lezhe	Kurbini	Fushe - Kuqe	Rikonstruksioni I rruges Fushe Milot - Gurrez	CEB	3.4	30-01-2009	30-05-2009	100%	92%	I
18	Lezhe	Kurbini	Fushe - Kuqe	Vazhdimi I Rruges Fushe Milot- Gurrez	CEB	3.73	3-10-2009	3-01-2010	97%	75%	II

19	Shkoder	Shkoder	Psotribe	Asfaltimi I rrugessë Kalasesë Drishit	CEB	3.0	20-01-2009	20-06-2009	100%	92%	I
20	Shkoder	Shkoder	Velipoje	Asfaltimi I rruges Luarze, Faza e Dyte	CEB	2.7	7-01-2009	27-05-2009	100%	90%	I
21	Shkoder	Shkoder	Postribe	Asfaltimi I rruges Koder- Boks	CEB	1.4	20-07-2009	20-12-2009	100%	92%	II
22	Shkoder	Shkoder	Postribe	Rikonstruksioni I rruges Kembesore Turistiketë Ura e Mesit	CEB	0.2	15-10-2009	15-03-2010	8%	0%	II
23	Shkoder	Shkoder	Velipoje	Asfaltimi I rruges Sektor Pulaj - Qerret	CEB	3.4	11-06-2009	11-11-2009	100%	92%	II
24	Tirane	Tirane	Petrole	Sistemim asfaltim I Rruga Mullet - Daias	CEB	2.3	26-01-2009	26-04-2009	100%	92%	I
25	Tirane	Tirane	Kryevidh	Rikonstruksion I rruges Spille 1	CEB	0.7	4-03-2009	4-06-2009	100%	92%	I
26	Tirane	Tirane	Petrole	Sistemim asfaltim I rruges Petrole	CEB	2.63	24-06-2009	24-12-2009	50%	39%	II
27	Vlore	Vlore	Orikum	Ndertimi I shetitoressë fshatit Radhime	CEB	0.9	25-03-2009	25-07-2009	100%	92%	I
28	Vlore	Vlore	Qender	Rikonstruksioni I rruges shkolla Narte - Tec	CEB	1.6	5-01-2009	5-07-2009	100%	92%	I
29	Vlore	Vlore	Orikum	Rikonstruksioni I rruges Dukat Fshat	CEB	2.4	8-01-2010	8-06-2010	0%	0%	II
30	Vlore	Vlore	Qender	Rikonstruksioni I rruges Narte - Zvernec	CEB	4.67	26-06-2009	26-10-2009	100%	92%	II

## 5.2 Informacion mbi nen-projektet e programit “Rruget Dytesore & Lokale”, financuar nga Banka Boterore (IDA) (Dhjetor 2009)

NR	QARKU	RRETHI	NJQV	LLOJI I PROJEKTIT	DONATORI	GJATESIA E INVESTIMIT (Km)	DATA E FILLIMIT	DATA E MBARIMIT	% REALIZIMIT TEKNIK	% REALIZIMIT FINANCIAR
1	Kukes	Kukes	Domaj	Rikonstruksioni I rruges Domaj - Ura e Lapave	IDA - GOA	11.5	19-11-2009	20-06-2010	60%	59%
2	Fier	Fier	Strum	Rikonstruksioni I rruges Strum - Qafe e Marinzes	IDA - GOA	12.6	13-11-2008	25-10-2009	100%	82%
3	Tirane	Tirane	Baldushk	Rikonstruksioni I rruges Ura e Farkes - Qender Fshat	IDA - GOA	6.5	25-11-2008	24-07-2009	98%	65%
4	Diber	Diber	Kastriot	Rikonstruksioni irruges Gryka e Gobenit - Perroi I Kapsit	IDA - GOA	9.8	27-11-2008	26-11-2009	82%	45%

## 5.3 Informacion mbi nen-projektet e programit “Rruget Dytesore & Lokale”, financuar nga OFID

(Dhjetor 2009)

NR	QARKU	RRETHI	NJQV	LLOJI I PROJEKTIT	DONATORI	GJATESIA E INVESTIMIT (Km)	DATA E FILLIMIT	DATA E MBARIMIT	% REALIZIMIT TEKNIK	% REALIZIMIT FINANCIAR
1	Lezhe	Lezhe	Lezhe, Kolsh, Kallmet	Rikonstruksioni i rruges Lezhe - Kallmet.	OPEC	12.8	11-04-2009	12-05-2010	53%	37%
2	Vlore	Sarande	Xarre, Aliko	Rikonstruksioni Xarre-Fshati Pllake	OPEC	10.9	17-04-2009	17-02-2010	48%	41%
3	Korce	Korce	Cerrave, Vreshtas, Pojan	Rikonstruksioni rruges Lapidari (kryq. Podgorie) – Korite	OPEC	10.5	15-04-2009	15-02-2010	90%	56%
4	Elbasan	Elbasan	Belsh, Fierze	Rikonstruksioni i rruges Belesh – Fierze	OPEC	9.2	16-04-2009	16-01-2010	75%	49%
5	Gjirokastrer	Gjirokastrer	Lunxheri	Rikonstruksioni I Valare-Erind	OPEC	5.3	24-06-2009	24-12-2009	70%	17%
6	Berat	Berat	Velabisht, Sinje	Rikonstruksioni Ura e Gorices - Fshati Mbreshtan	OPEC	7.8	4-06-2009	4-02-2010	35%	28%
7	Shkoder	Shkoder	Vau I Dejes, Vig Mnele, Hajmel	Rikonstruksioni Vau I Dejes – Nenshat	OPEC	11.8	5-05-2010	12-03-2010	25%	20%

#### 5.4 Informacion mbi nen-projektet e programit “Rruget Dytesore & Lokale”, financuar nga Banka e Keshillittë Europes

NR	QARKU	RRETHI	NJQV	LLOJI I PROJEKTIT	DONATORI	GJATESIA E INVESTIMIT (Km)	DATA E FILLIMIT	DATA E MBARIMIT	% REALIZIMIT TEKNIK	% REALIZIMIT FINANCIAR
1	Tirane	Tirane	Baldushk	Rikonstruksioni I rruges Qender - Mustafa Kocaj	CEB	8.4	25-06-2009	25-04- 2010	16%	5%
2	Fier	Fier	Kuman, Zharrez, B. Fier	Rikonstruksioni I rruges Sheq - Marinz	CEB	15.7	1-06-2009	1-08-2010	42%	32%
3	Lezhe	Lezhe	Kallmet, Nenshat	Rikonstruksioni I rruges Kallmet-Nenshat	CEB	8.74	7-07-2009	7-06-2010	43%	28%
4	Durres	Kruje	Bubq, Ishem, Thumane	Rikonstruksioni I rruges Bubq - Ishem	CEB	13.4	15-07- 2009	15- 06-2010	48%	32%
5	Vlore	Sarande	Aliko	Rikonstruksioni I rruges Fshati Pllake - Cuke	CEB	11.5	25-06-2009	25-05- 2010	44%	51%
6	Diber	Diber	Fushe Cidhen, Slllove	Rikonstruksioni I rruges Prroi i Kapsit - Vleshe	CEB	12	17-07- 2009	17-11- 2010	29%	25%
7	Korce	Korce	Pojan, Vreshtas, Liqenas	Rikonstruksioni I rruges Korite - Liqenas	CEB	9.3	3-07-2009	3-06-2010	52%	43%
8	Kukes	Kukes	Ujmisht, Bushtrice, Grykcaj	Rikonstruksioni I rruges Ura e Lapajve - Bushtrice	CEB	7.19	25-06-2009	25-04-2010	6%	27%
9	Fier	Mallakaster	B. Ballsh, Aranitas, Selite	Rikonstruksioni I rruges Ballsh-Arrianita	CEB	6.7	3-07-2009	3-03-2010	45%	47%
10	Elbasan	Librazhd	Rrajce, Proptisht	Rikonstruksioni I rruges Urake - Golik	CEB	8.6	30-06-2009	30-04-2010	11%	24%
11	Diber	Diber	Slllove, Kala e Dodes	Rikonstruksioni I rruges Vleshe - Vasie	CEB	12.5	8-12-2009	8-01-2011	0%	20%

## 5.5 Tabela e Skemavetë ujësjellësve fizibel, programi “Ujësjetllësit Rurale”

28	50	Approved Schemes for RWS Programme							total =	7.731.938	aver.=222,37	sum = 34.770			
scheme nr.	nr of villages /scheme	Qark	District	Commune	Village	New / R ehav.	G ravity / P ump	Clusters	Cost	Progressive	€/ capita	nr. of beneficiaries	SF points	TF Final Rank (points)	
1	1	Kukes	Kukes	Shishtavec	Borje	N	G		167.440	167.440	140	1.200	42	93,33	
2	1	Kukes	Kukes	Shishtavec	Novosej	N	G		201.045	368.485	146	1.380	40	89,93	
3	1	Diber	Mat	Gurre	Mishter	N	G		125.668	494.152	157	800	40	87,17	
4	6	Shkoder	MM	Qender	Dober, Kalldrun, Jubice, Sterbeq, Kamice, Fllake	R	G	CLUSTER 5	1.091.922	1.586.074	201	5.425	49	85,01	
5	1	Diber	Diber	Kala Dodes	Ploshtan	N	G		159.683	1.745.757	182	876	41	82,00	
6	1	Shkoder	Puke	Blerim	Dardhe	N	G		247.597	1.993.354	202	1.224	44	80,00	
7	1	Shkoder	Puke	Qelez	Bushat	R	G		105.992	2.099.346	203	522	40	76,01	
8	1	Diber	Bulgize	Shupenze	Okshatine	N	G		30.000	2.129.346	205	1.150	38	73,57	
9	1	Diber	Bulgize	Gjorice	Cerenec Eperm	N	G		127.890	2.257.236	223	573	41	72,07	
10	1	Kukes	Kukes	Shishtavec	Shtreze	N	G		97.678	2.354.914	229	426	39	68,68	
11	1	Diber	Diber	Muhurr	Hurdhe Muhurr	R	G		121.420	2.476.333	221	550	36	67,89	
12	1	Diber	Diber	Qender Tomin	Bahute	R	G		62.552	2.538.885	220	284	35	67,07	
13	6	Diber	Diber	Melan	Melan, Ilnice, Greve, Trene, Pejke, Pjece	R	G	CLUSTER 2	533.625	3.072.510	225	2.376	34	65,06	
14	3	Diber	Mat	Komsj	Bater 1+2, Frankth	N	G	CLUSTER 4	495.706	3.568.216	245	2.024	39	64,89	
15	2	Diber	Diber	Arras	Sine 1+2, Frankth	R	G	CLUSTER 1	339.903	3.908.119	234	1.450	35	63,63	
16	1	Diber	Diber	Selishte	Kacni	N	G		103.894	4.012.013	235	443	35	63,60	
17	2	Shkoder	Puke	Iballe+Qelez	Berishe Vendi & Midhe	N R	G	CLUSTER 6	253.064	4.265.077	257	985	38	61,02	
18	5	Kukes	Tropoje	Margegaj	Paqe, Flumi, Shoshan, Margegaj, Kocanaj	R	G	CLUSTER 7	928.106	5.193.183	238	3.898	33	60,83	
19	1	Kukes	Has	Krume	Gajrep	R	G		144.412	5.337.595	257	561	37	59,95	
20	1	Shkoder	Puke	Gjegjan	Shkoze	R	G		154.823	5.492.418	243	637	32	58,67	
21	1	Shkoder	MM	Shkrel	Zagore	R	G		326.246	5.818.664	281	1.160	40	57,02	
22	1	Kukes	Kukes	Malzi	Shemri	R	G		205.345	6.024.009	264	777	34	55,42	
23	1	Kukes	Tropoje	Bujan	Markaj	N	G		214.195	6.238.204	272	788	35	54,54	
24	1	Kukes	Kukes	Shishtavec	Oreshke	N	G		115.876	6.354.080	290	400	39	54,02	
25	1	Diber	Diber	Selishte	Qafe Murre	N	G		123.235	6.477.315	287	429	37	52,70	
26	5	Diber	Mat	Baz	Karice, Baz, Fbaz, Drita, RRBaz	R	G	CLUSTER 3	959.627	7.436.942	282	3.407	35	52,15	
27	1	Kukes	Tropoje	Bytyc	Prush	N	G		121.285	7.558.227	282	430	34	51,11	
28	1	Kukes	Kukes	Ujmisht	Lusen	R	G		173.711	7.731.938	292	595	29	43,94	

sum = €7.731.938 av = 222,37 €/c total = 34.770 beneficiaries

<b>RWSP1</b>	KfW1 = 5.150	LC1 = 1.000	in: 1000€	Cont1 = 1.200	Sum1 = 7.350	<b>total RWSP1+2 = €7.460.000</b>
<b>RWSP2</b>	KfW2 = 1.100	LC2 = 210		Cont2 = 149	Sum2 = 1.459	<b>Cont. included = €8.809.000</b>

- This is the final list including all approved villages after Feasibility Studies
- Schemes that totally fulfil the criteria of the RWSP for financing are 28 having 50 villages altogether
- Total cost of 28 schemes = **€7.731.938**

**TABELAT FINANCIARE.****5.6 Realizimi i zëravetë buxhetit për vitin 2009 (sipas donatoreve)**

(Kursi këmbimit 1Euro=122 leke 1USD=90leke ;1Euro =1.35 \$)

viti 2009

Donatori	IDA SLR 4459			OPEC/SLR			CEB \SLR			KFW II-IV			CEB-FAZA III			Fondetë Veta ADF		
Kategoria	Buxheti vjetor USD	Realizimi në \$	%	Buxheti vjetor	Realizimi ne USD	%	Buxheti vjetor	Realizimi ne USD	%	Buxheti vjetor	Realizimi ne USD	%	Buxheti vjetor	Realizimi ne USD	%	Buxheti vjetor	Realizimi ne USD	%
Punime Civile	3,755,000	2,763,989	74%	6,453,644	4,765,359	74%	7,546,500	7,547,045	100%	47,667	47,533	100%	6,722,511	6,700,511	100%	55,556	47,689	86%
Asistence Teknike	880,000	546,278	62%	-	-		-	-		534,244	533,211	100%	189,778	132,122	70%	75,889	4,289	6%
Design&superv.	960,000	836,711	87%	-	-		-	-		-	-	0%	-	-		-	-	
Training	92,000	76,122	83%	-	-		-	-		-	-	0%	94,889	66,411	70%	8,000	7,833	98%
Investime & Paisje FSHZH	371,000	292,600	79%	-	-		-	-		-	-	0%	108,444	20,322	19%	8,000	6,933	87%
Kosto Operative	810,000	809,667	100%	-	-		-	-		189,778	65,089	34%	111,222	111,185	100%	84,000	66,967	80%
Rezerve	-	-		-	-		-	-		-	-	0%	-	-		-	0	
<b>T o t a l i</b>	<b>6,868,000</b>	<b>5,325,367</b>	<b>78%</b>	<b>6,453,644</b>	<b>4,765,359</b>	<b>74%</b>	<b>7,546,500</b>	<b>7,547,045</b>	<b>100%</b>	<b>771,689</b>	<b>645,833</b>	<b>84%</b>	<b>7,226,845</b>	<b>7,030,551</b>	<b>97%</b>	<b>231,444</b>	<b>133,711</b>	<b>58%</b>

Donatori	Beneficiary			GOA Kosto Lokale			GOA TVSH			GOA Investime		
Kategoria	Buxheti vjetor	Realiziminë USD	%	Buxheti vjetor	Realizimi ne USD	%	Buxheti vjetor	Realiziminë USD	%	Buxheti vjetor	Realizimi ne USD	%
Punime Civile	766,256	764,644	100%	939,111	694,722	74%	4,986,833	4,986,833	100%	1,225,767	1,225,533	100%
Asistence Teknike	-	-		182,000	177,211	97%	-	-		-	-	
Design&superv.	-	-		691,444	520,378	75%	-	-		-	-	
Training	-	-		23,000	20,167	88%	-	-		-	-	
Investime & Paisje FSHZH	-	-		137,111	42,200	31%	-	-		-	-	
Kosto Operative	-	-		703,622	573,100	81%	-	-		-	-	
Rezerve	-	-		-	-		-	-		-	-	
<b>T o t a l i</b>	<b>766,256</b>	<b>764,644</b>	<b>100%</b>	<b>2,676,289</b>	<b>2,027,778</b>	<b>76%</b>	<b>4,986,833</b>	<b>4,986,833</b>	<b>100%</b>	<b>1,225,767</b>	<b>1,225,533</b>	<b>100%</b>

## 5.7 Shpenzimet sipas Donatoreve dhe Kategorive per vitin 2009 (ne 000, Leke)

Kategorite Category	IDA (SLR)	CEB SLR	OPEC	CWP Faza III Kredi & Grant	SIF(III) +II	RWS(KFWI V)	Beneficiary	GOA VAT	GOA Investime	GOA Partic.	Other Source "Petty cash"	Total
<b>Punime Civile</b> Civil Work	248,759	679,256	427,648	603,046	3,906	-	68,818	448,815	107,472	62,525	4,292	2,654,537
<b>Asistence Teknike</b> T. A.	49,165	-	-	11,891	-	47,989	-	-	-	15,949	386	125,380
<b>Design &amp;Superv.</b>	75,304	-	-	-	372	-	-	-	2,826	46,834		125,336
<b>Kualifikime</b> Training	6,851	-	-	5,977	-	-	-	-	-	1,815	705	15,348
<b>Paisje</b> Equipment	26,334	-	-	1,829	-	-	-	-	-	3,798	624	32,585
<b>Sh.Operative</b> Op. Cost	73,860	-	-	10,229	32	5,826	-	-	-	51,579	6,027	147,553
<b>Rezerve Fonde</b>		-										
<b>TOTAL USD</b>	<b>480,273</b>	<b>679,256</b>	<b>427,648</b>	<b>632,972</b>	<b>4,310</b>	<b>53,815</b>	<b>68,818</b>	<b>448,815</b>	<b>110,298</b>	<b>182,500</b>	<b>12,034</b>	<b>3,100,739</b>